

University for Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Summer 7-2020

KRIMINALITETI EKONOMIK NË VEÇANTI PASTRIMI I PARAVE NË KOSOVË GJATË PERIUDHES 2015-2017

Arbnora Çollaku

University for Business and Technology - UBT

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Law Commons](#)

Recommended Citation

Çollaku, Arbnora, "KRIMINALITETI EKONOMIK NË VEÇANTI PASTRIMI I PARAVE NË KOSOVË GJATË PERIUDHES 2015-2017" (2020). *Theses and Dissertations*. 1642.

<https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd/1642>

This Thesis is brought to you for free and open access by the Student Work at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in Theses and Dissertations by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact knowledge.center@ubt-uni.net.



Kolegji UBT
Fakulteti Juridik

**KRIMINALITETI EKONOMIK NË VEÇANTI PASTRIMI I PARAVE
NË KOSOVË GJATË PERIUDHES 2015-2017**

Shkalla Bachelor

Arbnora Çollaku

Korrik/2020
Prishtinë



Kolegji UBT
Fakulteti Juridik

Punim Diplome
Viti akademik 2015/2016

Arbnora Çollaku

**KRIMINALITETI EKONOMIK NË VEÇANTI PASTRIMI I PARAVE
NË KOSOVË GJATË PERIUDHES 2015-2017**

Mentori: PhD Cand.Elmi Kelmendi

Qershor/2020
Prishtinë

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të
pjeshme për Shkallën Bachelor

ABSTRAKT

Ky punim shqyrton Kriminalitetin Ekonomik në Republikën e Kosovës, duke u fokusuar në periudhën tre vjecare 2015,2016 dhe 2017 pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. Punimi ka modelin teorik i cili si pikë fillimi shqyrton Kriminalitetin Ekonomik i cili shpjegon sjelljen kriminale, duke kaluar tek përshkrimi se si Pastrimi i Parave ka efekt negativ në shkallën e krimit. Duke i kushtuar vëmendje të vecant Pastrimit të Parave, si një ndër veprat më të rënda të Kriminalitetit Ekonomik dhe një fenomen mjaftë i dëmshëm kriminal ndaj të cilit Kosova nuk është imune.

Pastrimi i Parave shfaqet dhe zhvillohet në forma të ndryshme dhe si fenomen është i kufizuar në sjellje të penalizuara nga ligjet penale, në mënyrë që të rritet efikasiteti i ligjit penal në luftën kundër Pastrimit të Parave. Padyshim që vendi jonë është i obliguar që kohë pas kohe të krijoj mekanizma për parandalimin dhe shtrengimin e këtij fenomeni, sepse dihet që Pastrimi i Parave padyshim ka një efekt negativ në një vend. Përmes këtij punimi do të analizohen dhe prezantohen ligjet, strategjitë dhe raportet të cilat janë aplikuar apo mund te aplikohen në shtetin e Kosovës. Zbatimi i ligjeve në praktikë tregon nevojën për një kuptim të drejtë të formave të kryerjes së Pastrimit të Parave pasi që pasojat e tij janë përhapur gjerësisht në aspektin ekonomik, shoqërorë dhe politik.

Përmes këtij punimi do të trajtojmë edhe problematikën si dhe ndikimin apo efektin e këtij fenomeni pasi që Pastrimi i parave është krim në vetvete si dhe instrument për kryerjen e krimeve të tjera në mënyrë të vecantë krimeve të tjera ekonomike, krimit të organizuar, terrorizmit, korrupsionit e kështu me rradhë.

Poashtu punimi fokusohet te studimi i paraqitjes së Kriminalitetit Ekonomik dhe përhapja e tij, te llojet e paraqitjes së Kriminalitetit Ekonomik veqanërisht tek Pastrimi i Parave, te mënyrat e paraqitjes së tij, si dhe te rëndësia dhe pasojat e dëmshme që shkaktohen në të tilla raste.

Nëpërmjet kontrollit të Krimeve Ekonomike në përgjithësi edhe Pastrimit të Parave si lloj në vecanti izolohen këto dëme apo vepra të kundërligjshme të cilat prekin shoqërinë dhe shtetin në terësi, funksionimin e sistemeve ekonomike dhe moralin publik.

MIRËNJOHJE/FALENDERIME

Ju më e dashura ime Familje, nuk ka gjë që e dua dhe e vlersojë më shumë se ju. Ekzistenca juaj, fjalët e menqura dhe dashuria e pakushtëzuar kanë qenë motivi im, duke më bërë kjo që jam sot, do të jem gjithmonë mirënjohëse dhe krah jush me dashurinë dhe kujdesin përtej çdo mundësie.

Ky paragraf tjetër i përket udhëtimit tim akademik, ku dëshiroj të shpreh mirënjohjen time më të thellë mbikqyrësit dhe pedagogut tim Prof. Elmi Kelmendi, pa dyshim që ky studim nuk do ishte kompletuar pa ndihmën, profesionalizmin dhe mbështetjen e tij të dobishme, gjatë gjithë kohës që më ka udhëhequr.

Sigurisht e gjithë kjo do të më ndihmojë shumë për tu bërë një Juriste më e mirë dhe për të promovuar rrugën e karrierës sime të nisur në fushën e Juristes.

Përfundimisht do të doja të jap falenderimin tim të sinqertë të gjithë atyre që më ofruan mbështetje, motivim, inkurajim, ndihmë dhe asistencë gjatë studimeve të mia për marrjen e gradës Bachelor.

PËRMBAJTA

LISTA E TABELAVE.....	IV
FJALORI I TERMAVE.....	V
1. HYRJJE.....	1
2. SHQYRTIMI I LITERATURËS	
2.1. KRIMINALITETI EKONOMIK.....	3
2.1.1 FORMAT E PARAQITJES SË KRIMINALITETIT EKONOMIK	5
2.1.2 FORMAT DHE VECORITË E KRIMINALITETIT EKONOMIK DHE KRYERSVE TË KRIMINALITETIT EKONOMIK	7
2.1.3 EFEKTET DHE KOSTOT E KRIMINALITETIT EKONOMIK	11
2.1.4 NDJEKJA PENALE E KRIMINALITETI EKONOMIK.....	12
2.1.5 DREJTORIA PËR HETIMIN E KRIMEVE EKONOMIKE DHE KORRUPSIONIT.	15
2.2 PASTRIMI I PARAVE	16
2.2.1 FAZAT NË TË CILAT KALON PASTRIMI I PARAVE.....	19
2.2.2 EFEKTET NEGATIVE TË PASTRIMIT TË PARAVE NË EKONOMI	22
2.2.3 KORNIZA LIGJORE PËR PASTRIMIN E PARAVE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS	23
2.2.4 DOKUMENTET STRATEGJIKE TË PASTRIMIT TË PARAVE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS ..	24
2.2.5 AKTET JURIDIKE NDERKOMBËTARE NË RAPORT ME PASTRIMIN E PARAVE	27
2.2.6 NDJEKJA PENALE E PASTRIMIT TË PARAVE.....	28
2.2.7 NJËSIA PËR INTELIGJENCË FINANCIARE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS	31
2.2.8 ADMINISTRIMI I PASURISË SË SEKUESTRUAR APO TË KONFISKUAR.....	32
2.2.9 AGJENCIA PËR ADMINISTRIMIN E PASURISË SË SEKUESTRUAR OSE TË KONFISKUAR ...	34
2.2.10 SHEMAJ TË PASTRIMIT TË PARAVE NGA VENDET E HUAJA	36
3. DEKLARIMI I PROBLEMIT	38
4. METODOLOGJIA.....	40
5. PREZANTIMI DHE ANALIZA E REZULTATEVE	41
6. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	43
7. REFERENCAT.....	45

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Dinamika e veprave penale kundër Ekonomisë për periudhën 2015/16 dhe 2017 (Departamenti i Krimeve të Rënda)	12
Tabela 2. Dinamika e veprave penale kundër Ekonomisë për periudhën 2015/16 dhe 2017 (Departamenti i Përgjithshëm)	13
Tabela 3. Pasqyra mbi aktivitetet e Pastrimit të Parave për periudhën 2015/16 dhe 2017 (Departamenti i Krimeve të Rënda)	28
Tabela 4. Pasqyra mbi aktivitetet e Pastrimit të Parave për periudhën 2015/16 dhe 2017 (Departamenti i Përgjithshëm)	29

FJALORI I TERMAVE

KGJK – Këshilli Gjyqësor i Kosovës

DP – Departamenti i Përgjithshëm

DKR – Departamenti për Krime të Rënda

PP – Pastrimi i Parave

KPRK – Kodi Penal i Republikës së Kosovës

KE – Kriminaliteti Ekonomik

FBI – Byroja Federale e Hetimeve

NJIF – Njësia e Intelgjencës Financiare

BQK – Banka Qendrore e Kosovës

RKS – Republika e Kosovës

VP – Veprat Penale

FATF – The Financial Action Task Force

1. HYRJE

“Kriminaliteti Ekonomik kërcënon njerëzit në çdo aspekt të jetës së tyre, bashkë me Pastrimin e Parave, këto janë veprimtari serioze kriminale, rëndësia e të cilave nuk duhet të minimizohet pasi që mbi dhe përtej ndikimit të tyre social dhe ekonomik ato shpesh janë të lidhura ngushtë edhe me krime të tjera, mandje edhe me terrorizmin. Kriminaliteti Ekonomik varion nga vjedhjet themelore ose mashtrimet e kryera nga individë, me qëllim të operacioneve në shkallë të gjerë të cilat drejtohen nga kriminelë të organizuar. Gjithashtu mundësitë për të fituar para në mënyrë të paligjshme janë në dukje të pafundme, ku për kriminelët e kësaj fushe rreziqet paraqiten të ulëta dhe përfitimet e larta. Bandat kriminale veprojnë në mënyrë transnacionale për të shmangur zbulimin, dhe fondet e vjedhura duke i kaluar ato nëpër shumë kufij fizikë dhe virtualë përpara se të arrijnë në destinacionin e tyre përfundimtar” (*Interpol,2019*).

Në këtë kohë KE duke përfshirë të gjitha veprimet që i mbartë me vete të cilat janë të llojeve të ndryshme dhe të kundërligjshme, ka zgjëruar përhapjen e tij me motiv të përfitimit ekonomik në mënyra dhe forma të ndryshme në të cilat paraqiten këto veprime. Ky lloj krimi nuk ka të bëjë me përdorimin e dhunës fizike, por ky lloj krimi ka të bëjë me aftësinë e dijes dhe manipulimeve për qëllime jo të mira. Mbrapa këtyre krimeve paraqiten edhe përsonave me pozita të larta të cilët shfaqin një aftësi të dëmshme dhe egoizem, i cila për shoqërinë tonë është shkatërrues. Kriminaliteti ekonomik paraqitet në format e tij të cilat janë të shumta, dhe përsona të shumtë apo individë kyqen në këto rrjedha në mënyrë që të pasurohen në mënyrë më të shpejtë, duke lënë anash të mirën e shtetit dhe shoqërisë duke u kyqur në afëra të ndryshme. Një ndër arsyet përse këta përsona vendosin që të bëhen pjesë e këtyre veprimtarive janë krizat ekonomike në vendin tonë, por poashtu edhe dukuri të tjera shoqërore.

“Fenomenet e dëmshme shoqërore mund të parandalohen dhe të luftohen në mënyrë efektive vetëm nëse më parë hulumtohen e studiohen në mënyrë të gjithëanëshme, shoqëria e organizuar dhe juridikisht e rregulluar formave të ndryshme të patologjisë shoqërore sic është kriminaliteti mund t'ju kundërvihet duket marrë masa adekuate preventive e represive kur paraprakisht të jenë studiuar dimensionet, vëllimi, paraqitja e tyre dhe rrethanat që i shkaktojnë ato” (*A.Krasniqi,2003*). Pra mos zbulimi dhe mos ndëshkimi i krimeve sjellë pasoja në

mospengimin e shfaqjes së tij.

Si një ndër veprat më të vecanta dhe serioze të kriminalitetit ekonomik përmendim 'Pastrimin e Parave', i cili paraqitet si problem për sigurinë e vendit. Proces ky i gjenerimit të parave të pista në para të pastërta edhe pse këto para në thelb dihet që nuk mund të jenë të pastërta por përsona të caktuar vendosin që përmes mekanizmave dhe fazave të ndryshme të bëjnë që këto para të fituara nga aktivitete kriminale të dalin si para të pastërta me qëllim të fshehjes së këtyre të ardhurave kriminale. Të ardhurat ekonomike të cilat fitohen nga krimi nuk mund të shpenzohen aq lehtë, për këtë arsye vendoset që të bëhet pastrimi i këtyre parave që të paktën për të shfrytëzuar një pjesë të konsiderueshme të tyre të cilat janë marrë nga aktivitete të paligjshme.

Krimet në përgjithësi dhe akti i paligjshëm i PP, janë fenomene të lidhura ngushtë me njëra tjetrën. "Njësoj edhe për këtë vepër duhet të vlejë rëndësia për luftimin e tij, të bëhet konfiskimi i të ardhurave kriminale dhe të dënohen kriminelët të cdo niveli dhe në vecanti kriminelët e shkallës së lartë, të cilët kryesisht qëndrojnë menjëherë nga aktivitetet kriminale, sepse bashkëjetesa e nevojshme me krimin e bënë pastrimin e parave të dëmshëm, andaj duhet të egzistojë një bashkëpunim i ndërsjellë i brendshëm dhe ndërkombëtar, të avancohen teknika të reja hetimore dhe të zbatohen ligjet, apo të hyjë në fuqi dhe plotësisht të zbatohet "Ligji Anti-Mafia" që të arrihet një sukses në luftën kundër kriminalitetit ekonomik dhe pastrimit të parave, në mënyrë që të shmangen vështirësitë e kësaj lufte" (*Ekonomia-Ks*).

Reagimi i shoqërisë tonë, i organeve ligjvënëse, i mediave ndaj këtij fenomeni duhet të jetë i vazhdueshëm dhe me vendosmëri të luftohet paraqitja e tij, sepse keto lloje të Krimit paraqesin shkallë shumë të lartë të rrezikshmërisë shoqërore.

2. SHQYRTIMI I LITERATURËS

2.1. KRIMINALITETI EKONOMIK

“KPRK është instrument themelor i shtetit juridik ngase shërben për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave më të rëndësishme të cdo qytetari dhe të mbarë shoqërisë, në këtë kod penal janë të cekura qartë veprat penale kundër ekonomisë” (I.Salihu,2016). “Kriminalitetin Ekonomik mund ta përkufizojmë si forma të llojllojshme të sjelljeve kriminale të personave fizik dhe juridik në sferën e qarkullimit financiar dhe afarizëm, të drejtuara kundër sistemit ekonomik, pavarësisht nga statusi ligjor i pronës e që janë të inkriminuara me ligj penal ose ligje të tjera si vepra të ndaluara dhe të dëmshme shoqërore” (A.Krasniqi,2003).

Pra kur flitet për Kriminalitetin Ekonomik vlerësohet se ky lloj krimi gjeneron një dëm të konsiderueshëm shoqëror kjo për shkak se nuk prek dhe nuk dëmton vetëm institucionet demokratike por në anën tjetër minon edhe thesarin e shtetit duke shkurtuar burimet e mundshme për zbatimin e politikave publike. Kështu KE mbulon një gamë të gjërë të veprave penale nga krimet financiare të kryera nga bankat, pastrimi i parave, evazioni i taksave, krimet e kryera nga zyrtarët publik si ryshfet, përvetësim etj. KE shpesh kryhen nga akterë të fuqishëm të lidhur me pushtetin politik dhe ekonomik, ky fenomen lidhet ngushtë me ndjekjen selektive dhe joefikase të këtij lloji të krimeve dhe të atyre që janë përgjegjës dhe që dëshmojnë pandëshkueshmërinë strukturore në sistemin tonë gjyqësor ndaj këtij aktiviteti kriminal i cili gjenerohet nga një fuqi e fshehur që përcakton marrëdhëniet midis ekonomisë dhe politikës. KE ka qenë dhe është një shqetësim madhor me efekt negativ mjaft të dëmshëm për shoqëritë e ndryshme me vite apo dekada të tëra, pra është një pasqyrë negative mbi shoqërinë. Krimet ekonomike janë veprime kriminale të cilat si motiv kanë përfimimin e paligjshëm të cilat motive kërcenojnë rëndë të drejtat e njeriut, sigurinë, demokracinë e vendit apo zhvillimin e saj dhe të shtetit në tërësi.

“Për përcaktimin e saktë të KE, nuk është e mjaftueshme vetëm mbështetja në dispozitat juridike sepse KE nuk është vetëm kategori juridike, por mbi të gjitha edhe fenomen shoqëror që ka tipare të shumta, midis të cilave ka edhe karakteret juridike të cilat duhet të merren në konsiderim dhe të respektohen gjatë përcaktimit të tij. Pikpamja më e përhapur e cila bazohet në klasifikimin juridik të së drejtës penale materiale është ajo pikpamje e cila i konsideron kriminalitetit ekonomik ato veprimtari me të cilat sulmohet sistemi ekonomik nacional, veprime këto të cilat janë inkriminuar me dispozitat e kodit penal” (M.Suceska,2006). Me rastin e sulmimit të sistemit ekonomik shkaktohen humbje të të ardhurave publike dhe ndërkombëtare si dhe çënohet besimin tek sistemi ekonomik i vendit.

“Pra veprimet Kriminale Ekonomike janë ato veprime që pengojnë afarizmin ekonomik, ndërsa pjesëmarrësve në këtë afarizëm u shkaktojnë dëme të mëdha materiale dhe financiare. Përcaktimi dhe përkufizimi i këtij fenomeni është mjaft kompleks si në suaza mbrenda një shteti poashtu edhe në suaza ndërkombëtare, megjithatë KE paraqet një lami të formave dhe veprimeve kriminale që kryhen në ekonomi dhe si forma dominuese të prezentuara nga shumë autorë përmenden: deliktet e kartelave të mëdha, aktet e mashtrimit dhe keqpërdorimit të gjendjes ekonomike të kompanive multinacione, mashtrimet në përfaqësime dhe

keqpërdorimi i lejeve ndërkombëtare për tregti dhe afarizëm, veprimi fiktiv dhe ilegal i ndërmarrjeve dhe firmave të ndryshme, falsifikimi i librave financiare, konkurrenca jolojale, favorizimi i firmave, marrja e provizioneve gjatë tenderave, keqpërdorimi i fondeve dhe donacioneve, deliktet në qarkullimin e të hollave dhe letrave me vlerë, deliktet bankare dhe transaksionet e ndaluara, larja e parave, marrja e mitos, bishtërimi i pagimit të tatimit, doganave dhe pagesave të tjera të parapara me ligj, korrupsioni dhe forma të tjera të këtyre sjelljeve kriminale. Një numër i konsiderueshëm i KE ngel përgjithmonë i pazbuluar për këtë arsye tek kriminaliteti ekonomik konsiderohet se 'numri i errët' është shumë i lartë, edhe pse realisht në botën bashkëkohore është një ndër krimet më të pranishme. Të gjitha këto veprime ndërmirren për qellime të përfitimeve materiale dhe financiare dhe të gjitha këto veprime nuk janë të bazuara në punë dhe aktivitete të lejuara dhe të mirëfillta por në keqpërdorime, mashtrime dhe transaksione të dyshimta.

Sipas pohimeve në literaturën kriminologjike dëmet e shumta materiale që shkaktohen nga ky kriminalitet i tejkalojnë disa herë dëmet të cilat shkakohen nga format tjera tradicionale të sjelljeve kriminale, kështu dëmet materiale të cilat shkaktohen nga format e ndryshme të kriminalitetit ekonomik sot maten me miliarda dollarë, derisa në vitet 60,70 dëmet nga kriminaliteti ekonomik vlerësohen me qindra miliona dollarë, sot flitet për shuma fantastike të dëmeve që vlerësohen me qindra miliarda dollarë” (R.Halili,2011).

Për dallim nga kriminaliteti i përgjithshëm, krimet ekonomike në masë të mjaftueshme dallojnë prej tyre me disa karakteristika si përshembull, tek kriminaliteti i përgjithshëm sjelljet kriminale zakonisht janë transparente dhe pasojat e tyre janë më të dukshme në jetën e përditshme. Kryerësit e veprimeve kriminale te krimet e përgjithshme në shumë raste i hetojnë dhe i identifikojnë menjëherë, përkundër kësaj kur bëhet fjalë për kriminalitetin ekonomik nuk ndodh e njëjta gjë, ngase mënyra e kryerjes së këtyre krimeve bëhet në mënyrë të fshehtë dhe pasojat e tyre nuk janë të drejtëpërdrejta dhe transparente. Kështu ndaj këtij kriminaliteti reagohe vetëm pasi të dalë në shesh veprimtaria e tillë kriminale, sa më afatgjata të jenë këto veprime kriminale në ekonomi aq më të mëdha janë dëmet që shkaktohen.

2.1.1 Format e paraqitjes së Kriminalitetit Ekonomik

Kriminaliteti Ekonomik shfaqet në disa forma të cilat paraqiten poashtu si vepra penale në vete ku si pasojë e tyre cënohet ekonomia në përgjithësi, pra ato veprime me të cilat rrezikohet pasuria private dhe shtetërore.

“Sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës - Pjesa e Përgjithshme (Kapitulli XXV) si Vepra Penale Kundër Ekonomisë paraqiten:

- 278/ Cenimi i barazisë në ushtrimin e veprimtarisë ekonomike
- 279/ Veprimtaria e pandergjegjshme ekonomike
- 280/ Shkaktimi i falimentimit
- 281/ Shkaktimi i falimentimit të rrejshëm
- 282/ Mashtrimi në procedurën e falimentimit
- 283/ Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve
- 284/ Keqpërdorimi i autorizimeve ekonomike
- 285/ Lidhja e kontratës së dëmshme
- 286/ Komunikimi i paautorizuar i sekretit tregtar
- 287/ Falsifikimi i letrave me vlerë dhe instrumenteve të pagesës
- 288/ Falsifikimi i shenjave me vlerë
- 289/ Cenimi i të drejtave të patentës
- 290/ Cenimi i të drejtave të autorit
- 291/ Shmangia e masave teknologjike
- 292/ Mashtrimi i konsumatorëve
- 293/ Mashtrimi i blerësve
- 294/ Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm
- 295/ Keqpërdorimi i pozitës së monopolit
- 296/ Falsifikimi i parasë
- 297/ Prodhimi dhe përdorimi i shenjave të etiketimit, masave dhe peshave të rreme
- 298/ Prodhimi, furnizimi, shitja, posedimi ose dhënia në shfrytëzim e mjeteve për falsifikim
- 299/ Tregtia e ndaluar
- 300/ Prodhimi i ndaluar
- 301/ Lëshimi i ceqeve pa mbulesë ose të rreme dhe keqpërdorimi i kartelave të bankës apo të kreditit
- 302/ Shpërlarja e parave
- 303/ Marrëveshjet për kufizimin e konkurrencës përmes ftesave për tender
- 304/ Mashtrimi në shkëmbimin e letrave me vlerë
- 305/ Keqpërdorimi i informatave të brendshme
- 306/ Marrëveshja dhe mashtrimi me letrat me vlerë të Qeverisë
- 307/ Shmangia nga tatimi
- 308/ Dokumentet e rrejshme lidhur me tatimin
- 309/ Pranimi i paarsyeshëm i dhuratave
- 310/ Dhënia e paarsyeshme e dhuratave

- 311/ Kontrabandimi i mallrave
- 312/ Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore ose tarifave akcizore”
(GZK.RKS-GOV, Prishtinë 2019).

2.1.2 Format dhe Vecoritë e Krriminalitetit Ekonomik dhe kryesve të Krriminalitetit Ekonomik

“Në jetën e përditëshme të afarizmit ekonomik-financiar, vërehen disa vecori të kriminalitetit ekonomik si në suaza brenda një shteti ashtu edhe në ato ndërkombëtare. Kryersit e këtyre krimeve ose organizatat e tyre kriminale shërbejnë me një varg manipulimesh dhe transaksionesh legale, gjysëmlegale dhe ilegale. Në literaturën bashkëkohore kriminologjike, si transaksione të tilla numërohen: themelimi i firmave apo ndërmarrjeve fizike në vend ose jashtë vendit me qëllim të fshehjes së tatimit, manipulimi me letra tjera me vlerë, shfrytëzimi i premive të ndryshme të eksportit dhe rieksporit, kontrabandimi me mallra të ndryshme duke iu ikur tatimeve doganore si p.sh: importimi ilegal i derivateve të naftës, duhanit, alkoolit, rregullimi fiktiv i tenderave dhe favorizimi i firmave të ndryshme për shkak të provizioneve që merren etj (*R.Halili, 2011*).

Të shpeshta janë “rastet e mashtrimeve që i bëjnë disa firma të dyshimta ose fiktive ndaj qytetarëve ose partnerëve tjerë, si ofrimi i deponimeve të parave me kamata të larta dhe pse nuk ka bazë dhe mundësi, skemat pyramidale, dhënia e parave me fajde, blerja dhe shitja e pasurisë së patundshme, investimet e parave në aksionet e dyshimta, formimi i bankave dhe institucioneve të dyshimta dhe fiktive financiare e të tjera. Esenciale të këto veprime kriminale është fakti se kryersi i krimit shfrytëzon gjendjen e rënde dhe kritike në të cilën ndodhet viktimja, ose joshë lakminë e madhe të saj për pasurim të shpejtë dhe pa ndonjë bazë të shëndoshë financiare. Në këtë aspekt vecmas janë të njohura veprimet kriminale të firmave individëve dhe grupeve të caktuara të cileve u mundësohet në mënyrë jolegale përparësia në kredi, bishtërim të pagesave të tatimit, subvencione dhe lehtësime tjera që sjellin përfitime të mëdha, në këtë mënyrë duke anashkaluar normat dhe rregullat ligjore afariste, disa firmave dhe individëve u mundësohet pasurimi dhe beneficionet që nuk u takojnë. Në bazë të kësaj paraqitet konkurrenca jolegale ose monopoli në treg që nuk është produkt i afarizmit të mirëfillt ose i gjendjes së rregullt të prodhimit, por është rezultat i manipulimeve dhe transaksioneve të ndaluara dhe kriminale” (*W.Tupman, 2015*).

Sjellje të tilla delikvente në ekonominë bashkëkohore ka shumë dhe janë faktorë kryesorë të paraqitjes së krizave dhe depresioneve ekonomike, sociale dhe politike në shumë vende të botës. Për trajtimin e kriminalitetit ekonomik me rëndësi është të vecohen edhe disa

karakteristika tjera të tij si në vijim ku opinion i gjërë, jo ai profesional në mënyrë të bujshme dhe të ashpër reagon ndaj disa formave të krimit të zakonshëm, të kriminalitetit konvencional si ndaj vrasjeve të rënda, dhunimeve seksuale, vjedhjeve dhe plackitjeve të pasurisë private, e në anën tjetër reagimi ndaj KE është shumë i butë dhe joadekuat.

“Disa autorë në kërkimet e tyre mbi këtë formë të kriminalitetit dhe duke u bazuar në rezultatet e anketave të zhvilluara, kanë ardhur në përfundim se delikuenti ekonomik, kriminel i disa formave të krimeve ekonomike si p.sh mashtrimeve, transaksioneve të ndryshme nga të cilat nxjerrë përfitime të mëdha, jo vetëm që nuk gjykohet, por në një mënyrë gëzon njëfarë simpatie, bile në disa raste bëhet edhe njëfarë lloj heroi i mjedisit të caktuar sepse ka treguar mjeshtëri e aftësi të vecanta të mashtrisë shtetin apo firmën tjetër dhe të pasurohet pa djersë.

Veprimet e tilla kriminale edhe pse janë të parapara si vepra penale kundër ekonomisë apo delikte ekonomike, sipas ligjeve pozitive të gati të të gjitha shteteve bashkëkohore, jo vetëm që rrallë ndiqen por edhe në opinionin e gjërë nuk hasin në ndonjë gjykim. Për këtë arsye në jetën e përditëshme, sot shumë qytetarë nuk e kanë të qartë vijën e demarkacionit në mes të asaj që është afarizëm i lejuar në pajtim me normat ligjore dhe kriminalitetit ekonomik i cili është i ndaluar” (*Slideshare, 2011*). Për shkak të çështjeve të tilla qytetarin e rëndomtë nuk e brenë ndërgjegjja që kryersin e veprave të tilla nuk e denoncon në polici, ngase kjo është konsideruar si një lloj shkathtësie dhe aftësie që nuk duhet të denoncohet.

“Përkundër disa karakteristikave të përbashkëta që ka me kriminalitetin e përgjithshëm, kriminaliteti ekonomik ka edhe disa vecori specifike mjaftë të theksuara. Kryersit e krimeve ekonomike dhe krimeve të organizuara në ekonomi, në shoqërinë bashkëkohore rëndomë nuk janë tipa asocial ose nuk duken si të tillë. Ata nuk përdorin dhunën fizike sic veprojnë rëndomë kriminelët e nëntokës dhe të dhunës kalsike. Këta kriminel në shikim të parë në asnjë cilësi të jashtme nuk u përngjajnë kriminelëve që zakonisht opinion i konsideron si të tillë. Përkundrazi këta individ edhe pse kryejnë krime shumë të rënda me pasoja të shumefishta, me gjithë veprimtarinë antiligjore dhe antisociale, në të shumtën e rasteve trajtohen si qytetarë të respektuar dhe të ndëruar, si afaristë të shkathtë, si ekonomistë të shquar, si organizatorë të shkëlqyeshëm e në disa raste edhe si politikanë dhe qeveritarë të njohur. Në shumë raste ndodh që edhe kur të zbulohen veprimet e tyre kriminale ata mbrohen në opinion, i shmangen policisë, ndjekjeve penale dhe gjykimit. Me fjalë të tjera egziston një praktikë që veprimet e tyre kriminale të minimizohen ose të mos denoncohen, kjo praktikë

ndodhë për arsye se ata kanë arritur që në bazë të transaksioneve dhe manipulimeve të ndryshme ta përfitojnë ambientin sociokulturor, socioekonomik dhe establishmentin politik dhe qeveritar” (A.Krasniqi, 2003). Në anën tjetër kryersit e tillë me anë të dhënies së mitos apo rryshfetit kanë arritur që ti korruptojnë dhe blejnë për vete të gjithë, prej nënpunësve të thjeshtë të administratës lokale, policisë lokale e deri te piramida qendrore e pushtetit administrativë, policorë, gjyqësor dhe shtetërorë.

“Në literaturën kriminologjike bashkëkohore kryersit e kriminalitetit ekonomik shpeshherë ndahen në disa shtresa:

Shtresa e parë: E përbëjnë të ashtuquajturit kriminelë ose ‘njerëz afaristë të imët’. Qellimi i tyre është sigurimi i një egzistence të domosdoshme jetësore, e jo grumbullimi i parave dhe kapitalit të madh. Kjo është e ashtuquajtura shtresë e ulët e KE.

Shtresa e dytë: Ose shtresa e mesme e kriminelëve ekonomik, përfshinë kategorinë e përsoneve që janë të motivuar të grumbullojnë pasuri, të arrijnë një status material ekonomik më të lartë dhe me këtë të realizojnë edhe disa privilegje politike dhe ndikime të tjera në botën afariste. Këta kriminelë zakonisht lëshohen edhe në manipulime, transaksione dhe në spekulime të llojllojshme, në bursë, tregti, banka dhe mashtrime të tjera të cilat sipas logjikës së tyre ‘paguhen’. Këtu vecmas vërehet angazhimi i tyre në korruptimin e segmenteve të ndryshme të pushtetit administrativë, policorë, gjyqësorë dhe politikë. Për këte punë kriminale ata tregojnë aftësi të rralla.

Shtresa e tretë: Ose shtresa më e lartë, e përbëjnë përsoneat që zënë pozita të larta ekonomike dhe politike. Shpesh këta përsone mbajnë pozita të rëndësishme në strukturat e partive politike, ministrive të ndryshme në sektorët e ekonomisë, bankave, marrëdhënieve tregtare me botën e jashtme ose gjenden vetë në segmente ku bëhën investime të mëdha, ose i kanë njerëzit e vetë. Në këtë mënyrë ata kanë mundësi që gati legalisht e pa vështirësi të sigurojnë informata, programe, kredi, licenca, lehtësi dhe favorizime tjera për vete ose për bashkëpunorët e vetë në firma dhe ndërmarrje të tjera. Kështu ata realizojnë mjete materiale, financiare në shuma të mëdha duke u bërë të fuqishëm dhe duke ndikuar në shumë rrjedha ekonomike dhe politike në një vend. Fatkeqësisht këto ndikime dhe këtë forcë këta individë ose grupe të tyre i shfrytëzojnë për interesat e veta, për grumbullim të pasurisë për vete, e në dëm të ekonomisë dhe interesave të përgjithëshme. Kjo është shtresa më e lartë e kriminelëve dhe ky është kriminaliteti më i rrezikshëm ngase me së paku ndiqet e nga ana tjetër më së

shumti është në situatë të dërrmojë dhe shkatërrojë themelet e ekonomisë së një vendi. Kjo formë e kriminalitetit ekonomik është shumë e ngjajshme me kriminalitetin e organizuar profesional. Ky kriminalitet në pjesën më të madhe është i ndërlidhur me njerëzit në pushtet pra me ata të cilët sipas pozitës dhe obligimit ligjorë janë të thirrur ta luftojnë krimin, e në realitet ata vetë kryejnë këto krime ose i ndihmojnë të tjerët që të kryejnë krime të tilla, me qëllim të përfitimit personal” (R.Halili,2011).

2.1.3 Efektet dhe Kostot e Kriminalitetit Ekonomik

Krimet Ekonomike nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm, kjo ndodh për shkak të natyrës së tyre jo të dhunëshme, prandaj si pasojë e kësaj krimet e tilla nuk morën vëmendjen e duhur të publikut. Të gjitha aktivitetet e kriminimit të KE kanë pasojat të mëdha duke shtrembëruar imazhin dhe reputacionin e vendit, pasojat nga këto aktivitete shkojnë përtej humbjes financiare dhe mirëqenies ekonomike të shoqërisë, pra këto krime ekonomike dhe financiare mbeten përherë armiq shkatërrues të shtetit. “Kështuqë qeveritë duhet të luftojnë kundër krimeve ekonomike në çdo formë të mundshme, sepse është e rëndësishme që njerëzit të ndjehen se po jetojnë në një shoqëri të drejtë dhe nese këto krime nuk kontrollohen njerëzit do të fillojnë e të ndjehen gjithnjë e më të indinjuar. Kur kemi të bëjmë me disa krime ekonomike sic janë: manipulimi i cmimeve të aksioneve, tregtimi i brendshëm të cilat nuk dëmtojnë drejtpërdrejtë jetën e njerëzve duke ndikuar kështu tek ata në mënyrë indirekte, i bënë njerëzit të ndjehen të lehtësuar mirëpo efektet që krijojnë këto aktivitete në shoqëri nuk duhet të jenë një fushë e interesit e nënvlerësuar.

Krimi në përgjithësi dhe krimet ekonomike në vecanti janë pjesë e madhe e çdo shoqërie. Në pikpamje ekonomike veprat penale mund të synohen kundër individëve, familjeve, shoqërisë publike, ndërmarrjeve tregtare, sektorit privat dhe publik.

Kostot dhe efektet e tyre prekin pothuajse të gjithë në një farë mase. Llojet e kostove dhe efekteve të tyre janë të shumëllojshme, disa kosto janë afatshkurtëra ndërsa të tjerët zgjasin një jetë, sigurisht që kostoja më e lartë dhe përfundimtare nga krimi është humbja e jetës” (United Nations, 2005). “Kostot dhe efektet tjera për viktimat mund të përfshijnë: kostot mjekësore, humbjet e pronës, humbjen e të ardhurave, poashtu krimi jo vetëm që çon në dëmtimin financiar ose fizik dhe kostot e parandalimit, por gjithashtu ndikon indirekt në ekonominë lokale, rajonale dhe kombëtare të një vendi duke ndikuar kështu në rritjen ekonomike, të ardhurat, fuqinë punëtore, ndikimi në biznese duke zvogëluar konkurrencën e kompanive dhe investimet, dekurajimi në investimet direkte vendase dhe të huaja, ndikimi në turizëm, ndikimi në cilësinë e jetës pra në kapitalin shoqëror, ndikimi në vlerën e pasurisë etj” (Assets Publishing Service.gov, 2018)

Me anë të këtyre veprave kriminale në Kosovë krijohen pasojat të mëdha negative të cilat

qytetarët i vuajnë cdo ditë, me anë të këtyre veprave rrezikohet siguria e vendit, vlerat me vitale të njëriut, pasuria, liria e lëvizjes së mallrave dhe kapitalit, papunësia dhe një varg vlerash tjera individuale, kombëtare dhe ndërkombëtare.

2.1.4 Ndjekja Penale e Kriminaliteti Ekonomik

Kur flasim për Kriminalitetin Ekonomik në të jo rastësisht përfshihen një sëri e tërë krimesh që tashme janë të përfshira në Kodin Penal të RKS, sepse shumë vepra penale të cilat kryhen duke lënë pasojë në ekonominë e vendit lidhen drejtpërdrejt me krimet ekonomike.

Veprat penale kundër ekonomisë si tërësi janë veprime të cilat paraqiten në forma të ndryshme të aktivitetit kriminal të drejtuara kundër sistemit ekonomik dhe funksionit të tij, andaj për shkak të peshës që e bartin këto vepra penale në sferën ekonomike dhe pasojat që i shkaktojnë ato padyshim që zënë vend të konsiderueshëm në statistikat e kriminalitetit.

Në tabelat e paraqitura më poshtë hyjnë të gjitha llojet e veprave penale kundër ekonomisë dhe raportohet vetëm për periudhen e caktuar 3 vjeçare.

Tabela 1. Dinamika e veprave penale kundër Ekonomisë për periudhën 2015/16 dhe 2017 (Departamenti i Krimeve të Rënda)

Emertimi i Gjykatës Themelore - GJITHSEJT GJYKATAT				Departamenti i Krimeve të Rënda (DKR)											
VEPRAT PENALE KUNDËR EKONOMISË	Lëndë të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese	Lëndë të pranuar në punë	Gjithsej lëndë në punë	Me Akgjykim				Me Akgjykim Lirues	Me Akgjykim Rrefuzues	Është parashkruar		Është zgjidhur në mënyrë tjetër	Gjithsej lëndë të zgjidhura	Lendët në kompetenc brenda gjykatë	Lëndë të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese
				Nga lëndët e zgjidhura me Aktgjykim Gjykues, lëndët sipas llojeve të denimeve						Relativ	Absolut				
				Denim me burgim	Denim me gjobe	Denim me kusht	Denime tjera								
VJETOR 2015	368	61	429	9	9	13	1	10	22	1	8	18	91	0	338
VJETOR 2016	338	60	398	12	10	17	0	3	42	0	11	11	106	4	288
VJETOR 2017	277	68	345	21	9	18	0	8	15	0	5	7	83	7	255

(Burim nga KGJK)

**Tabela 2. Dinamika e veprave penale kundër Ekonomisë për periudhën 2015/16 dhe 2017
(Departamenti i Përgjithshëm)**

Emertimi i Gjykatës Themelore - GJITHSEJT GJYKATAT								Departamenti i Përgjithshëm (DP)							
VEPRAT PENALE KUNDËR EKONOMISË	Lëndë të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese	Lëndë të pranuar në punë	Gjithsej lëndë në punë	Me Akgjykim				Me Akgjykim Lirues	Me Akgjykim Rrefuzues	Është parashkruar		Është zgjidhur në mënyrë tjetër	Gjithsej lëndë të zgjidhura	Lendet në kompetenc brenda gjykatë	Lëndë të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese
				Nga lëndët e zgjidhura me Aktgjykim Gjykues, lëndët sipas llojeve të denimeve						Relativ	Apsolut				
				Denim me burgim	Denim me gjobe	Denim me kusht	Denime tjera								
VJETOR 2015	716	171	887	8	52	66	1	7	30	7	25	41	237	1	649
VJETOR 2016	632	213	845	15	41	48	1	10	24	6	48	20	213	1	631
VJETOR 2017	635	302	937	12	49	60	0	11	20	3	33	22	210	0	727

(Burim nga KGJK)

Ky lloj kriminaliteti është një dukuri shumë e dëmshme. “Duke parë rrezikun e ulët dhe fitimet e larta që lidhen me krimin ekonomik e bëjnë atë një aktivitet shumë tërheqës për grupet e krimit të organizuar, por ky fenomen duhet luftuar nga personat të cilët janë të thirrur për ti luftuar dhe parandaluar këto vepra penale, ata duhet që me efikasitet të kryejnë punën e tyre sepse përndryshe ndjekja selektive dhe joefikase e këtij lloji të krimeve dhe të atyre që janë përgjegjës, dëshmojnë pandëshkueshmërinë strukturore në sistemin tonë gjyqësor ndaj këtij aktiviteti kriminal” (*Europol Europa*).

“Sektori më i rëndësishëm për zhvillimin dhe stabilitetin e një shteti është padyshim ekonomia, në anën tjetër krizat dhe pasojat që sjell ky grup i veprave penale kanë ndikim të fuqishëm në paraqitjen e krimit ekonomik dhe krimit në përgjithësi, andaj këto vepra penale duhet te luftohen dhe të parandalohen nga ana e shtetit me masa preventive adekuate dhe akte ligjore përkatëse, me qëllim të ruajtjes dhe forcimit të ekonomisë dhe rendit shoqëror të vendit.

Në ndjekjen penale të veprave penale shpesh edhe shfaqen pengesa të cilat ndikojnë në mungesën e efikasitetit për zbardhjen e tyre në terësi. Si pengesë në luftën kundër krimit ekonomik mund të jetë edhe mungesa e bashkëpunimit ndërkombëtar, kjo gjë ndodhë atëherë

kur nuk egziston një kulturë bashkëpunimi ndërkombëtar për luftën kundër krimit në përgjithësi. Poashtu si pengesë tjetër që zë vend dhe që autoritetet duhet ta luftojnë është zbulimi i personave nga fuqitë me ndikim që ndërhyjnë në këto vepra penale, edhe pse kjo shpesh është më e vështirë sesa vetë hetimi kjo gjë lidhet me faktin se krimet ekonomike shpesh kryhen nga persona të fuqishëm të lidhur me pushtetin politik dhe ekonomik” (*CIPCE.Org*).

2.1.5 Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit

“Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit është pjesë e Divizionit për Hetimin e Krimin, e cila vepron si drejtori e specializuar për Parandalimin, Hetimin dhe Zbulimin e Veprave Penale kundër Ekonomisë, Financave dhe Korrupsionit, duke krijuar kushte dhe angazhim për qasje pro-aktive, aplikim të metodave efikase, përdorim të teknologjisë bashkëkohore për luftimin me sukses të kësaj dukurie.

Vizioni i Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit, është ndërtimi i një shoqërie në Kosovë, pa kërcënime të korrupsionit dhe veprave tjera të Kriminalitetit Ekonomik. Kjo drejtori ka si mision parandalimin dhe luftimin e veprave penale kundër ekonomisë, financave dhe korrupsionit, hetimin e kryesve të veprave penale, gjurmimin, kapjen, dokumentimin e veprimtarisë kriminale dhe sjelljen e të dyshuarve para organeve të drejtësisë, si dhe përpilimi dhe implementimi e strategjive dhe planeve të veprimit për parandalimin dhe luftimin e krimeve ekonomike, korrupsionit dhe krimeve financiare. Veprimtaria kryesor e Drejtorisë është hetimi i rasteve të cilat parashihen në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, dhe akteve tjera nënligjore” (*KosovoPolice*).

“Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe të Korrupsionit, për luftimin me efikas të korrupsionit dhe krimin ekonomik dhe financiar, bashkëpunon ngushtë me të gjitha institucionet tjera të zbatimit të ligjit si Prokurorin, Gjykatat, Doganën e Kosovës, Njësia e Inteligjencës Financiare, Administrata Tatimore e Kosovës, Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, Zyrat Kadastrave dhe Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar, si dhe Agjencionet tjera relevante.

Departamenti i Hetimeve iu kushton fokus të veçantë fuqizimit të kapaciteteve përmes trajnimit të zyrtarëve policorë, avancimin e pajisjeve dhe ngritjen e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve vendore të agjencive të zbatimit të ligjit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar për shkëmbimin e informatave, bashkimin e lëndëve penale, konfiskimin e aseteve të fituara përmes veprave penale, arrestimin e personave të dyshuar, shkatërrimin e grupeve kriminale si dhe ofrimin e provave organeve të drejtësisë” (*KLI-KS.ORG,2011*).

2.2 PASTRIMI I PARAVE

Sipas Task Force për Veprimin Financiar (FATF), si organ mbikëqyrësi global i Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, “Qëllimi i një numri të madh të veprave penale është të gjenerojë një fitim për individin ose grupin që kryen veprën. Pastrimi i Parave është përpunimi i këtyre të ardhurave penale për të maskuar origjinën e tyre të paligjshme, ky proces ka një rëndësi kritike pasi i mundëson kriminelit të shijojë këto fitime pa rrezikuar burimin e tyre. Shitjet e paligjshme të armëve, kontrabanda dhe aktivitetet e krimit të organizuar përfshirë p.sh. trafikimin e drogës dhe prostitucionit, mund të gjenerojnë sasi të mëdha të të ardhurave. Skemat e përvetësimit, tregtimit të brendshëm, ryshfetit dhe mashtrimit gjithashtu mund të prodhojnë fitime të mëdha dhe të krijojnë nxitjen për të "legjitimuar" fitimet e paligjshme përmes pastrimit të parave. Kur një veprimtari kriminale gjeneron fitime të konsiderueshme, individi ose grupi i përfshirë duhet të gjejë një mënyrë për të kontrolluar fondet pa tërhequr vëmendjen për aktivitetin themelor ose personat e përfshirë. Kriminelët e bëjnë këtë duke maskuar burimet, duke ndryshuar formularin ose duke lëvizur fondet në një vend ku ka më pak të gjasa që të tërheqin vëmendjen.”(FATF-GAFI,2019).

“Pastrimi i Parave është një formë e vecantë e kriminalitetit të organizuar. Kjo dukuri kriminale ka të bëjë me veprimet të cilat ndërmirren në mënyrë që paratë e fituara nga transaksionet dhe aktivitetet kriminale të deponohen dhe investohen në punë dhe në veprimtari legale, e pastaj ato të përdoren si para të pastruara, të lara. Pastrimi i parave është përcaktuar si proces me të cilin paratë e fituara ilegalisht prezantohen si gjoja para të fituara në transaksionet e lejuara ekonomike dhe tentohet të përdoren për qëllime legjitime.

Akti i pastrimit të parave bëhet vetëm për pasurimin e fituar me aktivitete kriminale, ky aktivitet fshehtë prejardhjen e parave dhe në këtë mënyrë paraqitet që të humbet gjurma e fitimit dhe ato të përdoren për qëllime të tjera gjoja të pastra. Ky transaksion i cili quhet pastrim i parave u lejon kriminelëve që ti shijojnë frytet e krimeve të tyre, në këtë mënyrë shpeshherë realizohet një rregull e pashkruar se krimi paguhet madje edhe shumë mirë” (R.Halili,2011). Pastrimi i parave është i vështirë për t'u studiuar pjesërisht sepse është konceptualisht i pakapshëm, ruajtja e shumave të mëdha të kriminelët krijojnë rreziqe nga zbatimi i ligjit dhe nga grabitqarët e tjerë penalë, në këtë sens pastrimi ose të paktën ‘fshehja’, e cila është bërë ‘pastrim’ përmes zgjerimit ligjor të konceptit është një pjesë integrale e

procesit të krimit të rëndë.

“Statutet e pastrimit të parave natyrisht e bëjnë si krim transferimin e parave që rrjedhin nga pothuajse çdo veprimtari kriminale duke përfshirë: krimin e organizuar, aktivitete terroriste dhe transaksione droge etj., në kanale në dukje të ligjshme, në përpjekje për të maskuar origjinën e fondeve. Ligjet patjetër që duhet të synojnë ta parandalojnë dhe të kenë efekt pozitiv në ndëshkimin e aktiviteteve të pastrimit të parave, por institucionet shpeshherë janë ‘të verbër’ me qëllim të pastrimit të parave që ndodhin brenda institucioneve të tyre. Institucionet financiare duhet të raportojnë transaksione të mëdha parash, institucionet financiare gjithashtu u kërkohet të raportojnë transaksione të dyshimta, ose ato për të cilat ata kanë arsye të besojnë që janë të lidhura me aktivitetin kriminal, ose ato që duket se synojnë të shmangin nxitjen e kërkesave të raportimit të të ardhurave. Prandaj institucionet financiare gjithashtu duhet të zbatojnë procedura për të verifikuar identitetin e klientëve të tyre dhe të kontrollojnë identitetin e tyre kundër listave të terroristëve të njohur ose të dyshuar” (*Criminal.Findlaw,2019*).

“Në zhargonin e përditshëm thuhet se paratë e fituara nga aktiviteti kriminal si: trafiku ilegal i drogës, organizimi ilegal i prostitucionit, trafiku ilegal i armëve etj., quhen para të ndyra, të përlyera, të pista dhe ato zakonisht si të tilla nuk mund të qarkullojnë në transaksionet normale dhe legale në tregun e biznesit dhe veprimtarisë së bankave dhe bursave në botën bashkëkohre. Prandaj grupet dhe organizatat që merren me aktivitete kriminale nga të cilat rrjedhin paratë e tilla tentojnë me të gjitha mjetet dhe mënyrat që ato para të ndyra ti shëndrrojnë në para të pastra, që atyre të ju jipet legjitimitet që ato ti pastrojnë duke i plasuar në investime dhe transaksione legale nëpërmes bankave të ndryshme afariste apo nëpërmes investimeve në projekte të llojlojshme në mbarë botën. Me pastrimin e parave merren grupet dhe organizatat kriminale të cilat i realizojnë dhe fitojnë ato para, pra aktiviteti i pastrimit të parave paraqet një veprimtari ilegale të organizuar mirë me të gjitha tiparet e krimit të organizuar.

Dukuria e pastrimit të parave jo rastësisht implikon shumë vende të botës dhe institucionet e tyre bankare për cka shpeshherë lindin edhe afera dhe skandale të cilat kanë jehonë të madhe politike, por edhe ekonomike e financiare. Dukurinë kriminale të pastrimit të parave sipas konstatimeve të ekspertizës financiare, në shumë vende e kanë mundësuar edhe disa rregulla që kanë vlejtur në banka të ndryshme mbi garantimin e fshehtësisë së deponimit të parave në ato banka, shpeshherë bankieret nuk kanë kërkuar prejardhjen e të hollave sidomos ata të bankave të posaformuara. Por pas paraqitjes së rrezikut nga pastrimi i parave në shumica të mëdha dhe

tronditjeve që shkaktuan ato në disa shtete, nëpër disa banka u bë alarmimi dhe në këtë mënyrë filloi ndryshimi i këtyre dispozitave ligjore mbi deponimet, me qëllim që të pengohen transaksionet kundërligjore dhe kriminale që lidheshin me pastrimin e parave. Përkundër kësaj fatkeqësisht kjo nuk po e pengon dukurinë kriminale të pastrimit të parave, e cila pothuajse ka marrë hov në tërë botën” (*R.Halili, 2011*).

“Luftimi i pastrimit të parave shkon paralelisht me hetimin e krimeve me të cilat është i lidhur sepse shpesh ky krim është një përbërës i krimeve të tjera shumë më serioze sic është trafiku i drogës, plackitja ose zhvatja etj. Kështu me ushtrimin e këtyre veprimtarive, bandat kriminale lëvizin fonde të marra në mënyrë të paligjshme në të gjithë globin duke përdorur banka, kompani, ndërmjetës dhe transmetues të parave duke u përpjekur të integrojnë fondet e paligjshme në bizneset dhe ekonomitë legale, andaj hetimet financiare synojnë të identifikojnë origjinën, rrjedhën dhe vendndodhjen e të ardhurave të paligjshme dhe të demaskojnë rrjetet e përfshira, kështu pasuritë e fituara në mënyrë të paligjshme pastaj mund të ngrihen ose konfiskohen dhe autorët e veprave origjinale dhe të pastrimit të parave të ndjekën penalisht” (*Interpol,2020*). Pastrimi i parave është një operacion kyç i ekonomisë nëntokësore. Kjo gjë natyrisht që ka ndikuar në qeverinë e vendit dhe në të gjitha qeveritë e botës që të bëjnë përpjekje të vazhdueshme për gjetjen e mënyrave të reja për të parandaluar që kriminelët të përfitojnë nga krimet e tyre. Sipas përcaktimit pastrimi i parave përfshinë fshehjen, lëvizjen dhe investimin e të ardhurave të sjelljes kriminale, pavarësisht nga këto raste, pastrimi i parave dëmton përgjithësisht shoqërinë.

“Dukuria e pastrimit të parave është e pranishme në të gjitha shtetet e botës, por në mënyrë të veçantë ajo gjenë terren të përshtatshëm dhe dëmton më shumë shtetet e dobëta e me prapambetje relative ekonomike, shtetet në tranzicion dhe shtetet me probleme sociale-politike dhe pa stabilitet. Rreziku që paraqet për vendin tonë ky lloj kriminaliteti, si pjesë përbërëse e krimit të organizuar, është i madh edhe për shkak të pasojave të rënda që sjell andaj kërkon jo vetëm vlerësimin e tij nga ana e shtetit, por edhe organizimin në luftimin e tij” (*Juridiksi.E-moniste*).

“Paraja është faktori lëvizës në një varg krimesh, duke përfshirë trafikimin e drogës, korrupsionin, evazionin fiskal, mashtrimin, vjedhjen, trafikimin me qenie njerëzore dhe kontrabandën. Pastrimi i suksesshëm i parave lejon që kriminelët të gëzojnë fitime dhe të nxisin ciklin e kriminalitetit duke i vërë fondet në dispozicion për ri-investim në krim. Këto

krime shkaktojnë humbje të drejtpërdrejta financiare për individët, dëmtojnë komunitetin, dhe në disa raste edhe humbjen e jetës njerëzore. Kosova është e përkushtuar në zhvillimin dhe mbajtjen e politikave kundër pastrimit të parashë, luftimin e financimit të terrorizmit dhe krimit financiar për të rritur aftësinë e saj për t'iu përgjigjur këtyre rreziqeve” (MF.RKS.GOV, 2019).

2.2.1 Fazat në të cilat kalon Pastrimi i Parave

Cfarë ndodhë me paratë e papastruara, kjo gjë po që është me rëndësi të dihet sepse egzistojnë mënyra të qarkullimit të parave të papastruara sic janë:

- Një pjesë të parave të papastruara kriminelët i investojnë në veprimtari kriminale apo të paligjshme, me qëllim të ruajtjes së veprimtarisë kriminale.
- Një pjesë tjetër të parave kriminelët i investojnë në biznese të ndryshme në sektorin e ndërtimitarisë, tregitisë, bujqësisë etj.
- Pjesa tjetër e parave të papastruara ose pjesa më e madhe e tyre eksportohet jashtë, pra në banka të ndryshme të botës me ndihmën e punonjësve të tyre nga fusha e ekonomisë dhe financave.

Pastrimi i parave është proces i cili bëhet përmes tri fazave, të cilat bëjnë bashkimin apo përzjerjen e fondeve të cilat janë fituar ilegalisht me ato ligjore. Pra ky është nje cikel i cili ndiqet nga tri faza të vecanta të cilat janë:

Faza e parë: Vendosja

Kjo fazë përfshinë transferimin fizik të parave, ku pastruesi futë paratë e fituara nga veprimtaritë kriminale në sistemin financiarë duke përdorur të gjitha instrumentet financiare. “Pra kjo fazë paraqet hyrjen fillestare të parave ‘të pista’ në përgjithësi, kjo fazë shërben për dy qëllime: lehtëson kriminelin e mbajtjes dhe ruajtjes së sasive të mëdha të parave të mëdha dhe i vendos paratë në sistemin legjitim financiarë. Kjo për faktin se vendosja e shumave të

mëdha të parave (parave të gatshme) në sistemin e ligjshëm financiar mund të ngjallë dyshime për zyrtarët. Kjo fazë e vendosjes është më e ndërlikuara dhe shpesh përfshinë lëvizjen ndërkombëtare të fondeve, poashtu kjo fazë korrespondon me shkallën më të madhe të cenueshmërisë për kriminelin” (*MoneyLaundering, 2017*).

Faza e dytë: Shtresimi

Kjo fazë e dytë përfshinë kycjen në transaksione financiare, paratë e futura në sistemin financiarë ligjorë transferohen nga njëra bankë në tjetrën anëmbanë sistemit bankarë të një vendi. “Pra qëllimi kryesor i kësaj faze është ndarja e parave të paligjshme nga burimi i saj origjinal apo i paligjshëm, kjo pjesë e procesit është shpesh e ndërlikuar. Duke lëvizur paratë shpejtë dhe në zona të ndryshme, paratë mund të shndërrohen në mënyrë që të mos zbulohen përmes auditimeve, kjo bëhet përmes shtrirjes së sofistikuar të transaksioneve financiare që errësojnë gjurmët e auditimit dhe prishin lidhjen me krimin origjinal” (*MoneyLaundering, 2017*).

“Gjatë kësaj faze për shembull pastruesit e parave mund të fillojnë duke lëvizur fondet nga një vend në tjetrin, pastaj t’i ndani ato në investime të vendosura në opsione të përparuara financiare ose në tregjet e huaja duke i lëvizur vazhdimisht ato. Shtresimi është në thelb përdorimi i vendosjes dhe nxjerrjes pa pushim të të ardhurave, duke përdorur shumën të ndryshme çdo herë, për të bërë transaksione gjurmuese sa më të vështira” (*HG.Org*).

Faza e tretë: Integrimi

“Kjo fazë përfshinë fondet e pastruara, të cilat paraqiten si pasuri e pastër të cilat rihyjnë në ciklin ekonomik ligjor për tu investuar ose konvertuar në aktivitete të mirëfillta, në mallra me vlerë ose pasuri të patundshme. Në fazën e integritimit paratë i kthehen kriminelit nga ato që duket se janë burime të ligjshme, të ardhurat penale tani janë integruar plotësisht në sistemin financiarë dhe mund të përdoren për çdo qëllim” (*MoneyLaundering, 2017*).

“Integrimi është nxjerrja e parave në mënyrë që të mund të përdoret pa tërhequr vëmendjen nga zbatimi i ligjit ose organet tatimore. Pra qëllimi kryesorë në këtë fazë është ribashkimi i parave me kriminelin në një mënyrë që nuk tërheqë vëmendjen pra të duket sikur paratë vijnë nga një burim i ligjshëm” (*HG.Org*).

Kështu pastrimi i parave është një fenomen që përmbledh në vetvete dy krime të ndryshme:

1. Krimi kryesorë, i cili sjellë të ardhura që kanë nevojë ‘të pastrohen’ dhe

2. Krimi që kryen tjetërsimin e prejardhjes ilegale të fondeve.

Pastrimi i parave ka një qëllim: kthimin e të ardhurave nga krimi në para ose pronë që duket e ligjshme dhe që mund të përdoret pa dyshim e kjo gjë mund të arrihet nga fazat e lartëcekura të cilat janë mënyrat më të zakonshme që arrihet kjo gjë.

“Ironia e këtij debati është se aftësia e pastruesve për të lëvizur dhe fshehur para pasi të kenë depërtuar tashmë në sistemin financiar është të paktën po aq e rëndësishme sa roli fillestar i bankave. Kriminelët lëvizin para midis bankave, midis instrumenteve të ndryshëm financiarë dhe brenda dhe jashtë pasurive të prekshme siç janë: bizneset ose pronat. Kriminelët gjithashtu përdorin subjekte që nuk kanë prezencë fizike ose staf dhe ekzistojnë thjesht për të krijuar fatura dhe për të marrë para për shërbime jo-ekzistuese për të pastruar para” (*Juridiksi, E-moniste*).

“Njerëzit që kryejnë krime të rënda për përfitime ekonomike duan jo vetëm që t’i shmangen burgimit por edhe të shijojnë frytet e krimeve të tyre. Kjo kënaqësi shpesh merr formën e konsumit të menjëhershëm nganjëherë të dukshëm. Pastrimi i parave është një krim i ndërlikuar. Përsoneat që kryejnë fazat e pastrimit të parave mund të jenë subjekt i akuzave të pastrimit të parave, për më tepër individë që nuk janë në dijeni të përfshirjes së tyre të mundshme në një krim të tillë mund të përfshihen, siç është dikush që merr një depozitë në para nga një kriminel, duke mos ditur që personi është në të vërtetë një kriminel. Kontrollat e pastrimit të parave imponojnë detyrime të kushtueshme për bizneset dhe shoqërinë, ato meritojnë një analizë më të mirë të efekteve të tyre të mira dhe të këqija. Është me rëndësi të ceket se individët që mund të përfshihen në çështjet e pastrimit të parave mund të mos kenë pasur qëllim të përfshihen në veprime të tilla, siç janë bankierët ose llogaritarët, ata mund të bëhen pa dije pjesëmarrës në pastrimin e parave, për sa kohë që mbrojtja mund të përcaktojë se i pandehuri nuk ishte në dijeni të burimit të fondeve të paligjshme, kjo mbrojtje mund të ngrihet dhe mund të jetë e suksesshme. Kur llogaritarët, bankierët dhe profesionistët e tjerë futen në pastrim parash nga një kriminel agresiv, detyrimi mund të jetë një mbrojtje e vlefshme për ta. Nëse krimineli ka kërcënuar profesionistin ose familjen e tij ose të saj dhe nëse profesionisti nuk pranon të marrë pjesë në skemën e pastrimit të parave, detyrimi mund të deklarohet si mbrojtje për këtë akuzë” (*TNI.Org*).

2.2.2 Efektet Negative të Pastrimit të Parave në Ekonomi

“Vepra Penale e Pastrimit të parave ka të bëjë me të gjitha llojet e krimeve, kjo vepër kriminale padyshim që ka ndikim në të gjithë ekonominë dhe shoqërinë e një vendi duke penguar kështu zhvillimin ekonomik, politikë dhe kulturorë.

Pastrimi i parave është procesi i maskimit, përmes konvertimit, fshehjes dhe transferimeve, të ardhurave që rrjedhin nga aktiviteti i paligjshëm për të legjitimuar përdorimin e tyre në të ardhmen. Matja me saktësi e zhvillimit dhe e madhësisë së pastrimit të parave është e vështirë sepse është në përkufizim një veprimtari e fshehur por poashtu dhe pa diskutim një veprimtari me efekt negativ. Efektet negative të pastrimit të parave në ekonomi janë të vështira për tu numëruar, sidoqoftë është e qartë se aktivitete të tilla dëmtojnë jo vetëm institucionet financiare drejtpërdrejt, por edhe produktivitetin e vendit në sektorë të ndryshëm ekonomik, siç janë sektori real, sektori i tregtisë ndërkombëtare dhe flukset e kapitalit”

(Researchgate, 2018).

Disa nga efektet padyshim negative, që mund ti përmendim janë:

- ‘Pastrimi i parave dëmton institucionet e sektorit financiar që janë thelbësore për rritjen ekonomike (korrupsioni i brendshëm dhe dëmtimi i reputacionit).
- Zvogëlon produktivitetin në sektorin real të ekonomisë, duke devijuar burimet dhe duke inkurajuar krimin dhe korrupsionin, të cilat ngadalësojnë rritjen ekonomike.
- Shtrembëronë tregtinë ndërkombëtare të sektorit të jashtëm të ekonomisë dhe flukset e kapitalit (dëmtimi i reputacionit dhe shtrembërimi i tregut), në dëm të zhvillimit ekonomikë afatgjatë.
- Pastrimi i parave dëmton zhvillimin e sektorit privat të ligjshëm përmes furnizimit të produkteve me çmim nën koston e prodhimit, duke e bërë të vështirë konkurrencën e bizneseve legjitime.
- Flukset e mëdha të fondeve të pastruara të derdhura brenda ose jashtë institucioneve financiare mund të dëmtojnë stabilitetin e tregjeve financiare.
- Ulja e të ardhurave qeveritare, pastrimi i parave gjithashtu zvogëlon të ardhurat nga taksat pasi bëhet e vështirë për qeverinë të mbledhë të ardhura nga transaksionet e lidhura që ndodhin shpesh në ekonominë nëntokësore.

- Efektet socio-ekonomike të pastrimit të parave janë të ndryshme sepse paratë e ndyra të krijuara nga aktivitetet kriminale pastrohen në fonde të ligjshme, ato përdoren për të zgjeruar operacionet ekzistuese kriminale dhe për të financuar të reja.
- Komplikon përpjekjet e qeverisë për të menaxhuar politikën ekonomike.
- Kërcenon transaksionet ligjore.
- Dekurajon investimet e huaja.
- Sjellë pasoja negative për stabilitetin financiar të vendit dhe të performancës makroekonomike, duke rritur rrezikun e destabilitetit makroekonomik.
- Si pasojë e PP shfaqet edhe konkurrenca jolojale.
- Ndikon në rritjen artificiale të cmimeve.
- Bëhet shkak për ndryshimet në importet dhe eksportet.
- Crregullim të investimeve dhe kursimeve.
- Ndikon në statistikat ekonomike të vendit.
- Ndikon në rritjen e krimit.
- Ndikon në rritjen e terrorizmit” (*Fiumauritius.Org*), (*Waleolusi Files Wordpress,2002*).

2.2.3 Korniza Ligjore për Pastrimin e Parave në Republikën e Kosovës

“Kushdo që kryen Vepër Penale të Pastrimit të Parave dënohet sipas ‘Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit’.

Kuvendi i Republikës së Kosovës në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së RKS, në Qërshor të vitit 2016 ka miratuar Ligjin për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit LIGJI Nr. 05/L -096, ligj ky i cili përcakton masat, autoritetet dhe procedurat për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit. Dispozitat që përmban ky ligj janë të detyrueshme për të gjitha institucionet dhe njësitë përkatëse të tyre si dhe për të gjitha subjektet jo publike të cilat në njëfarë mënyre mund ti nënshtrohen aktiviteteve që ndërlidhen me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit. Ky ligj për qëllim ka implementimin e Direktives së BE-së 2015/849 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 maj 2015 për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Ky ligj në nenin 56 të kapitullit

VII përfshinë Veprat Penale të Pastrimit të Parave, ku definohet se Veprat Penale të Pastrimit të Parave janë të dënueshme me burgosje deri në dhjetë (10) vjet dhe me gjobë deri në tri (3) herë më të madhe, në vlerë të pasurisë e cila është subjekt i veprës penale” (GZK.RKS-GOV,2016).

“Vepra penale e Pastrimit të Parave në Kosovë është paraparë gjithashtu me Kodin Penal të Republikës së Kosovës (Pjesa e Përgjithshme) në Kapitullin e XXV-Veprat Penale Kundër Ekonomisë ku në nenin 302 specifikohet Shpërlarja e Parave” (GZK.RKS.GOV,2019).

2.2.4 Dokumentet Strategjike të Pastrimit të Parave në Republikën e Kosovës

Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018

“Vlerësimi i rrezikut kombëtar në vitin 2013 ka shërbyer si bazë për objektivat dhe veprimet e Strategjisë Shtetërore dhe Planit të Veprimit 2014-2018. Kjo gjë do të siguronte menaxhim të qëndrueshëm të rreziqeve. Qeveria e Republikës së Kosovës ka treguar vullnet për të luftuar kundër ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare. Kjo gjë është bërë duke hartuar dhe zbatuar një sërë ligjesh shtetërore në përputhje me standardet ndërkombëtare, si dhe duke krijuar mekanizmin për menaxhim të rrezikut, përfshirë këtu strategjinë e cila përbënë udhërrëfyesin për institucionet përkatëse të sektorit publikë, privatë dhe të tretë.

Qëllim kryesor i Strategjisë Kombëtare dhe Planit të saj të Veprimit 2014-2018 ka qenë të mbështesë arritjen e objektivave të Programit të Qeverisë së Republikës së Kosovës 2011-2014 të cilat kanë qenë:

- Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik
- Qeverisje e mirë dhe fuqizim i Sundimit të Ligjit
- Zhvillimi i kapitalit njerëzor
- Mirëqenia sociale

Poashtu qëllimet e Strategjisë Kombëtare 2014-2018 kanë qenë:

- Të mbështesë arritjen e objektivave të Programit Qeveritar të Republikës së Kosovës 2011-

2014

- Të reduktoj shkallën e ekonomisë joformale në 5% mes 2014 dhe 2018
- Të rris vlerën totale të konfiskimit të të ardhurave nga krimi” (*Kryeministri-KS,2014*).

Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023

“Strategjia dhe Plani i Veprimit për luftimin e ekonomisë joformale që paraqitet në këtë dokument është vazhdimësi e strategjisë paraprake 2014-2018. Strategjia paraprake për parandalimin e ekonomisë joformale, ka pasur ndikim pozitiv në parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale. Poashtu edhe ky është një dokument i hartuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës në bashkëpunim të plotë me partnerët e saj strategjikë si BE dhe SHBA për përmirësimin e niveleve të funksionimit të shtetit ligjor dhe demokracisë, zhvillimit shoqëror, përparimin në rrugën e aderimit të ardhshëm në BE si garantues i stabilitetit në rajon. Me këtë dokument qeveria synon që përmes institucioneve të sajë ligjzbatuese të parandalojë të gjitha format e ekonomisë jo-formale.

Vizioni i Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023, është zhvillimi i një sistemi të qëndrueshëm në Kosovë për të luftuar ekonominë joformale, financimin e terrorizmit dhe krimet tjera financiare për tu integruar në luftën rajonale dhe ndërkombëtare për të siguruar paqen sociale, mirëqenien, dinjitetin, barazi dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik në përputhje me politikat e Qeverisë së Kosovës. Ky është vizioni që orienton masat dhe aktivitetet e parapara në këtë dokument. Përmirësimi i punësimit, i burimeve publike, dhe forcimi i shtetit të së drejtës dhe i mirëqeverisjes janë fushat kryesore që kjo Strategji synon me vizionin e dokumentit themeltar të zhvillimit në Kosovë.

Objektivat strategjikë që synohen të arrihen nëpërmjet kësaj strategjie janë:

- Përmirësimi i cilësisë së qeverisjes në ekonomi nëpërmjet identifikimit, analizimit, trajtimit dhe monitorimit të luftimit të ekonomisë joformale, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
- Rritja e burimeve financiare për shërbimet publike si rezultat i të hyrave shtesë tatimore dhe nga konfiskimi i pasurisë së paligjshme” (*MF-RKS.GOV, 2019*).

2.2.5 Aktet Juridike Ndërkombëtare në raport me Pastrimin e Parave

“Bashkëpunimi ndërkombëtar është më se i nevojshëm, për arsye se autoritetet kompetente të Kosovës ndërmarrin sigurimin e masave më të gjera të mundshme të bashkëpunimit me autoritetet e shteteve të huaja me qëllim të këmbimit të informacioneve, hetimeve dhe procedurave gjyqësore në lidhje me masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë dhe urdhrave për konfiskim lidhur me mjetet e pastrimit të parave dhe pasurinë e fituar me anë të veprës penale dhe me qëllim të ndjekjes së kryerësve të pastrimit të parave dhe aktivitetit terrorist. Procedurat për sigurimin e bashkëpunimit janë përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale të RKS, dhe në dispozitat e tjera të tilla përkatëse të ligjeve në fuqi të cilat nuk janë në kundërshtim me të” (*Kuvendi5.Votaime,2016*).

Rëndësi të veçantë kanë aktet juridike ndërkombëtare (konventat, deklaratat, rekomandimet, planet e veprimit) të cilat trajtojnë fushën e pastrimit të parave, kriminalitetit të organizuar etj. Dokumentet më të rëndësishme ndërkombëtare janë:

- Konventa nr.141 e Këshillit të Evropës mbi larjen e parave dhe gjurmimin, marrjen e përkohshme të të hyrave të fituara me vepër penale, Strasburg 1990.
- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër kriminalitetit të organizuar transnacional me dy protokolet e saj, Vjenë 2000.
- Direktivat e Këshilli të Evropës për ndalimin e shfrytëzimit të sistemit financiar me qëllim të shpëlarjes së parave, Qipro 1991.
- Konventa mbi larjen e parave, gjurmimin, marrjen e përkohshme dhe marrjen e të hyrave të krijuara me veprër penale e vitit 1990.
- Konventa e KB kundër çarkullimit të paligjshëm të drogave dehëse dhe substancave psikotrope, e vitit 1988.
- Deklarata politike e Napolit dhe plani global i veprimit për luftimin e krimit të organizuar transnacional e vitit 1994. Me këtë deklaratë parashifet lufta kundër krimit të organizuar transnacional dhe luftimi i grupeve të krimit të organizuar si dhe marrja e pasurisë e fituar në mënyrë të paligjshme.
- Konventa mbi Europolin e vitit 1995. Me këtë konventë parashihet themelimi i policisë ndërkombëtare për luftimin e kriminalitetit të organizuar transnacional.
- Rezoluta e Bashkimit Evropian (95/C 327/04) për mbrojtjen e dëshmitarëve në luftën kundër kriminalitetit të organizuar ndërkombëtarë e dates 03.11.1995.

- Rekomandimi i Bashkimit Evropian Rec. (96), mbi luftimin e kriminalitetit të organizuar e vitit 1996.

- Rezoluta e Bashkimit Evropian mbi individët të cilët bashkëpunojnë në proceset gjyqësore kundër kriminalitetit të organizuar transnacional, datës 20 dhjetor 1996. Convention on the Establishment of a European Police Office (Europol Convention) done at Brussels, 26 jul 1995.

2.2.6 Ndjekja Penale e Pastrimit të Parave

Sipas statistikave të marra nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, vërehet një numër i vogël i veprës penale pastrimi i parave gjatë periudhës së caktuar 3 vjecare. Veper kjo e cila është paraqitur dhe vazhdon ende të paraqitet në masë të madhe në vendin tonë, por që në anën tjetër vërejmë një dobësi apo mosefikasitet në kryerjen e hetimeve, ngritjen e akuzave apo nxerrjen e vendimeve përfundimtare nga gjykatat lidhur me veprën në fjalë.

Tabela 3. Pasqyra mbi aktivitetet e Pastrimit të Parave për periudhën 2015/16 dhe 2017 (Departamenti i Krimeve të Rënda)

Emertimi i Gjykatës Themelore - GJITHSEJT GJYKATAT				Departamenti i Krimeve të Rënda (DKR)											
PASTRIMI I PARAVE	Lëndë të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese	Lëndë të pranuar në punë	Gjithsej lëndë në punë	Me Akgjykim				Me Akgjykim Lirues	Me Akgjykim Rrefuzues	Është parashkruar		Është zgjidhur në mënyrë tjetër	Gjithsej lëndë të zgjidhura	Lendet në kompetenc brenda gjykatë	Lëndë të pazgjidhura në fundë të periudhës raportuese
				Nga lëndët e zgjidhura me Aktgjykim Gjyqësor, lëndët sipas llojeve të denimeve						Relativ	Absolut				
				Denim me burgim	Denim me gjobe	Denim me kusht	Denime tjera								
VJETORE 2015	3	2	5	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	5
VJETORE 2016	5	3	8	2	0	0	0	0	0	0	0	0	2	0	6
VJETORE 2017	6	2	8	0	0	0	0	1	0	0	0	0	1	0	7

(Burim nga KGJK)

Në tabelen e dytë të paraqitur më poshtë ku si burim kemi KGJK-në, departamenti i përgjithshëm vërejmë një numër shumë të vogël të kësaj vepre penale.

Tabela 4. Pasqyra mbi aktivitetet e Pastrimit të Parave për periudhen 2015/16 dhe 2017 (Departamenti i Përgjithshëm)

Emertimi i Gjykatës Themelore - GJITHSEJT GJYKATAT				Departamenti i Përgjithshëm (DP)											
PASTRIMI I PARAVE	Lëndë të pazgjidhura në fillim të periudhes raportuese	Lëndë të pranuar në punë	Gjithsej lëndë në punë	Me Akgjykim				Me Akgjykim Lirues	Me Akgjykim Rrefuzues	Është parashkruar		Është zgjidhur në mënyrë tjetër	Gjithsej lëndë të zgjidhura	Lendet në kompetenc brenda gjykatë	Lëndë të pazgjidhura në fundë të periudhes raportuese
				Nga lëndët e zgjidhura me Aktgjykim Gjykues, lëndët sipas llojeve të denimeve						Relativ	Apsolut				
				Denim me burgim	Denim me gjobe	Denim me kusht	Denime tjera								
VJETORE 2015	2	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2
VJETORE 2016	1	1	2	0	0	0	0	0	0	0	1	0	1	0	1
VJETORE 2017	1	0	1	0	0	0	0	1	0	0	0	0	1	0	0

(Burim nga KGJK)

Edhe pse Kosova konsiderohet se ka shënuar progres në vendosje e një regjimi strategjik kundër pastrimit të parave. Ka adaptuar Strategjitë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për Parandalimin dhe Luftën kundër Ekonomise Joformale, Pastrimit të Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare. Megjithatë, reagimi institucional në luftën kundër pastrimit të parave vërehet edhe në tabelat e paraqitura më lartë që ka qenë i dobët, kjo për shkak të ndërhyrjeve politike, mungeses së gatishmërisë për të vepruar nga ana e institucioneve përkatëse, i cili është përcjellë me një mungesë të kapaciteteve për të trajtuar lëndet që kanë të bëjnë me pastrimin e parave, gjë që ka penguar dhe luftimin në kohë të kësaj vepre.

“Në përgjithësi mungesa e iniciativës dhe gatishmërisë për të punuar në veprat penale komplekse në lidhje me pastrimin e parave mund të jetë objekt i ndërhyrjeve të mundshme politike, gjë që mund të mos jetë raportuar nga ana e prokurorëve special. Deri më tani

prokurorët special rrallëherë kanë raportuar se kanë pasur ndonjë presion të jashtëm nga ana e të pandehurve të dyshuar, pasi që ata shumë rrallë kanë trajtuar rastet e profilit të lartë, duke përfshirë edhe rastet që përfshijnë figura politike të profilit të lartë. Roli që gjykatat kanë luajtur në këtë drejtim e kanë qar Kosovën larg nga krijimi i rezultateve të suksesshme në hetimin, ndjekjen penale dhe dënimin e veprave penale të pastrimit të parave dhe krimeve ekonomike në përgjithësi. Poashtu Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), duhet të rrisë kapacitetet e veta të monitorimit dhe të vlerësojë në thellësi llogaridhënien e shërbimeve të prokurorisë në zgjidhjen e lëndëve që kanë të bëjnë me pastrimin e parave duke mos lënë anash analizën e cila duhet të fokusohet edhe në gjetjen e arsyeve për rezultatet e dobëta në hetimin, ndjekjen dhe dënimin cilësorë të rasteve që kanë të bëjnë me PP.

Ndjekja e dobët shpeshherë është justifikuar me faktin se krimi i pastrimit të parave është për nga natyra çështje komplekse dhe shpesh përfshinë edhe transaksione ndërkombëtare të cilat është vështirë të ndiqen. Megjithatë përderisa pasuria e pashpjegueshme mbetet e paprekshme në Kosovë, prokurorët special vazhdojnë të rrinë në zonat e tyre të rehatisë, duke raportuar apo kërkuar shumë rrallë masa mbrojtëse” (*KIPRED,2016*).

Masat kundër pastrimit të parave janë të dizajnuara për të parandaluar keqpërdorimin e sistemit financiar. Ato bëjnë thirrje për zbulimin, raportimin, konfiskimin e flukseve të dyshimta financiare dhe sanksionimin e kriminelëve andaj institucionet e sistemit të drejtësisë në Kosovë duhet të jenë në gatishmeri për trajtimin sa më efikas të kesaj dukurie, sepse mungesa e konfiskimit të aseteve të fituara në këtë mënyrë të kunderligjshme, kryesisht përmes pastrimit të parave tregon mungesën e profesionalizmit gjatë trajtimit në masë të vogël të këtyre rasteve nga ana e Prokurorisë Speciale dhe Gjykatave të RKS.

“Veprat penale të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit hyjnë në kompetencën ekskluzive të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, të themeluar me Ligjin mbi Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës. Veprat tjera penale të përshkruara në këtë ligj hyjnë në kompetencën e prokurorëve të shtetit siç përshkruhet në Ligjin mbi Prokurorin e Shtetit dhe në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës” (*GZK.RKS-GOV,2016*).

2.2.7 Njësia për Inteligjencë Financiare në Republikën e Kosovës

“NJIF në Kosovë, është institucioni qëndror i pavarur kombëtar në kuadër të Ministrisë së Financave, është përgjegjës për kërkimin, marrjen, analizimin dhe shpërndarjen tek autoritet kompetente dhe bërjen publike të informacionit në lidhje me pastrimin potencial të parave dhe financimin e terrorizmit. Stafi profesional i NJIF-it nuk janë nëpunës civil, aktet nënligjore për organizimin e brendshëm administrativ dhe çështje tjera administrative të NJIF-it propozohen nga drejtori i këtij institucioni dhe aprovohen nga ana e Bordit të tij. Bordi përbëhet nga Ministri i Financave, i cili do të shërbejë në cilësinë e Kryetarit të Bordit. Anëtarë të tjerë të bordit do të jenë, ex officio, Ministri i Punëve të Brendshme, Kryeprokurori i Kosovës, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, Drejtori i Administratës Tatimore të Kosovës, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të Kosovës dhe Guvernatori i BQK-së.

NJIF i siguron në mënyrë periodike dhe kordinon vlerësimin kombëtar të rrezikut për sa i përket pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, për të identifikuar dhe vlerësuar rrezikun dhe për t’i bërë rekomandime Qeverisë në përcaktimin e politikave, strategjive dhe masave për menaxhimin e rrezikut dhe për të zvogëluar rreziqet e identifikuara dhe vlerësimi kombëtar i rrezikut ndërmerret së paku çdo tri(3) vite. Të gjitha subjektet raportuese përcaktojnë në mënyrë periodike rrezikun e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit ndaj të cilit janë të ekspozuara gjatë ofrimit të shërbimeve dhe produkteve të tyre, vendndodhjes gjeografike dhe mekanizmave e kanaleve të shpërndarjes. Vlerësimi i rrezikut u shpërndahet me kërkesë të NJIF-it dhe, për bankat dhe institucionet financiare, edhe BQK-së.

Për këtë qëllim, subjektet raportuese identifikojnë dhe vlerësojnë më tej rreziqet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit që mund të lindin në lidhje me zhvillimin e produkteve të reja dhe praktikave të reja të biznesit, përfshirë mekanizmat dhe kanalet e reja të shpërndarjes dhe përdorimin e teknologjive të reja dhe atyre në zhvillim për produkte të reja ose ekzistuese para futjes në përdorim të risive për sa i përket produkteve, praktikave të biznesit, kanaleve të shpërndarjes ose përdorimit të teknologjive të reja apo në zhvillim. të gjitha subjektet raportuese i kushtojnë vëmendje të veçantë çdo rreziku të pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit në lidhje me produktet apo transaksionet që promovojnë anonimitetin dhe marrin të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar përdorimin e tyre për qëllime të pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit.

Të gjitha subjektet raportuese raportojnë tek NJIF, sipas mënyrës dhe formës së specifikuar nga NJIF si në vijim:

Të gjitha aktivitetet ose transaksionet e dyshimta brenda njëzetekatër (24) orëve nga koha kur aktiviteti ose transaksioni është identifikuar si i dyshimtë dhe të gjitha transaksionet individuale në para të gatshme në vlerë dhjetëmijë (10.000) euro ose më shumë apo vlerës ekuivalente në valutë të huaj” (*GZK.RKS-GOV,2016*).

Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës është anëtare e Egmont Group dhe si rezultat i anëtarësimit të Egmont Group, është shënuar progres i theksuar i shkëmbimit ndërkombëtar të informacionit dhe ngritje e nivelit të bashkëpunimit ndërkombëtar ky anëtarësim kontribon fuqishëm në luftimin dhe parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, kjo gjë është shumë e rëndësishme për shtetin e Kosovës. Poashtu ndikon në ngritjen e kapaciteteve profesionale për stafin e NJIF nga ana e Egmont Group, si dhe në ofrimin e informatave për institucionet e zbatimit të ligjit në Republikën e Kosovës” (*MF.RKS-GOV, 2017*).

2.2.8 Administrimi i Pasurisë së Sekuestruar apo të Konfiskuar

"Kosova është një shtet i ri dhe në konsolidim e sipër. Historiku i procesit të konfiskimit së pasurisë në Kosovë megjithatë është më i hershëm sesa vetë shpallja e shtetësisë së saj. Dispozitat ligjore në Kosove për konfiskimin e pasurisë pas luftës dhe vendosjes së administrimit ndërkombëtare janë përcaktuar fillimisht me Kodin Penal të vitit 2004, po ashtu një bazë juridike për konfiskim të pasurisë ka ekzistuar edhe në periudhat e mëhershme gjatë administrimit të Kosovës nga sistemi juridik i Jugosllavisë. Megjithatë dispozitat të cilat kanë qenë që nga viti 2004 në Kodin Penal dhe atë të Procedurës Penale nuk kanë treguar sukses në luftimin e pasurimit të paligjshëm, për cka ka qenë më se e nevojshme që të hartohet një legjislacion i ri i cili në fakt do duhej të ndryshojë shume aspekte themelore të natyrshmërisë juridike që të arrihet sukses sa i përket kësaj çështje" (*Cohu.org,2016*).

"Kuvendi i Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në vitin 2016 ka miratuar, Ligjin për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar. Në bazë të këtij ligji me pasuri përkufizohet çdo fond apo pasuri, duke përfshirë

pasuri financiare, burime ekonomike, prona të çfarëdo lloji, të prekshme apo të paprekshme, të luajtshme apo të paluajtshme dhe dokumente ligjore apo instrumente të çfarëdo forme, përfshirë ato elektronike apo digjitale, që dëshmojnë tituj pronësie apo interes në fonde të tilla apo pasuri tjera, përfshirë por jo të kufizuara në kreditë bankare, çeqe udhëtarësh, çeqe bankare, urdhra për pagesë paraje, aksione, letra me vlerë, bono, drafte, apo letra krediti, dhe çfarëdo interesi, dividenda apo të ardhura tjera në to, vlera që rrjedhin të gjeneruara nga fonde të tilla ose pasuri tjera, të përvetësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë përmes veprës penale dhe çfarëdo të ardhurash në të cilat është shndërruar apo përzier dhe fondet apo pronat terroriste. Si pasoje e pasurimit në mënyrë të tërthortë pra përmes veprave penale vijmë deri te Konfiskimi i Pasurisë, i cili nënkupton marrjen e përhershme të pasurisë, të urdhëruar me vendim të formës së prerë nga gjykata, apo me Sekuestrim të Pasurisë që nënkupton marrjen e përkohshme të sendit në bazë të vendimit të gjykatës apo organit kompetent, në pajtim me ligjin.

Administrimi me Pasurinë nënkupton disponimin e plotë në përputhje me dispozitat e përcaktuara me këtë ligj që Agjencia bën me pasurinë e sekuestruar dhe konfiskuar, duke përfshirë magazinimin, ruajtjen e përkohshme, shitjen e pasurisë, dhënien me qira, dhënien në shfrytëzim pa kompensim dhe vlerësimin e vlerës së pasurisë së konfiskuar në pajtim me ligjin, derdhjen e mjeteve në të holla të fituara nga shitja e pasurisë së konfiskuar në pajtim me ligjin dhe çdo lloj aktiviteti tjetër të nevojshëm për të ruajtur dhe mbajtur vlerën e pasurisë" (*MD.RKS-GOV,2016*).

"Për t'u plotësuar me pas edhe me Ligjin për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë, Kuvendi i Republikës së Kosovës në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në vitin 2018, e miratoi atë. Qellimi i këtij Ligji është të përcaktojë kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë atëherë kur procedurat e detajuara në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës nuk janë të mjaftueshme" (*MD.RKS-GOV,2018*).

"Poashtu me Kodin Penal të Republikës së Kosovës, në Kapitullin e VII-të, përcaktohet Konfiskimi i Instrumentalitetit dhe Dobisë Pasurore të Veprave Penale. Neni 92, Konfiskimi i mjeteve dhe dobisë pasurore të veprave penale, përcakton se Pasuria ose mjete që është përfituar me vepër penale konfiskohet sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Në rastet kur konfiskimi nuk është i mundur në pajtim me paragrafin

1 të këtij neni, Gjykata urdhëron kryesin e veprës për të paguar një shumë të barasvlershme ose Gjykata do të konfiskojë çdo pasuri të të pandehurit me vlerë të barasvlefshme siç është përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës" (MD.RKS-GOV,2019).

2.2.9 Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar

"Ministria e Drejtësisë në kuadër të angazhimeve të saja për përmbushjen e aktiviteteve në zbatimin e Ligjit Nr.03/L-141, për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar, ka themeluar Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, e cila është Agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.

Me qëllim të ngritjes së efektivitetit dhe efikasitetit në administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar është bërë plotësim ndryshimi i Ligjit Nr.03/L-141 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar, me Ligjin Nr.05/L-049 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, i cili e përcakton Agjencinë si organ qendror i administratës shtetërore në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.

Kjo Agjenci si mision ka bashkëpunimin me organet e drejtësisë, në mënyrë që ta luftoj krimin e organizuar dhe korrupsionin në Republikën e Kosovës, duke kryer funksionet e saja me qëllim që të ofrojë administrim të leverdishëm dhe profesional të pasurisë dhe të zhvilloj këto funksione me integritet dhe transparencë. Pra objektivi kryesor i Agjencisë është të bëhet qendër profesionale në administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar. Të gjitha funksionet në lidhje me administrimin e pasurisë, Agjencia i kryen në bazë të vendimit të gjykatës ose sipas detyrës zyrtare.

Agjencia është e pavarur në kryerjen e funksionit të vet në pajtim me Kushtetutën, ligjet dhe aktet nënligjore dhe asnjë organ ose institucion publik nuk ka të drejtë që në çfarëdo mënyre të ndikojë në punën e Agjencisë.

Agjencia përbëhet nga:

1. Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm
2. Drejtoratet
 - a. Drejtorati i Pranimit, Ruajtjes së Vlerës dhe Shitjes së Pasurisë së Sekuestruar ose të

Konfiskuar me sektorët përkatës

b. Drejtorati për Punë Normativo Juridike dhe Administratë me sektorët përkatës" (*MD.RKS-GOV*).

"Ligj për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar i RKS, përcakton funksionet dhe përgjegjësitë e Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar. Në kuadër të drejtave dhe detyrave të parapara me ligj, Agjencia kryen këto funksione si ne vijim:

- Administron me pasurinë e sekuestruar dhe të konfiskuar të përdorura për, apo të përfituara nga vepra penale, përfshirë pasurinë e terrorizmit, me përjashtim të pasurisë së konfiskuar për realizimin dhe mbledhjen e detyrimeve tatimore.
- Ekzekuton urdhrin e gjykatës për masën e përkohshme për sigurimin e pasurisë, sipas legjislacionit në fuqi.
- Ekzekuton aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës, sipas legjislacionit në fuqi, mund të bëjë shitjen e sendeve duke derdhur të ardhurat e grumbulluara nga shitja në buxhetin e Kosovës ose dorëzimin e pasurive për shfrytëzim nga Qeveria.
- Bën vlerësimin e vlerës së pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar, si dhe përcakton mënyrën e ruajtjes së kësaj pasurie.
- Mbanë evidencat për pasurinë të cilën e administron dhe për vendimet gjyqësore në të cilat është vendosur për pasurinë e sekuestruar dhe të konfiskuar.
- Përcakton mënyrën e ruajtjes së vlerës së pasurisë nën administrim.
- Merr pjesë në ofrimin e ndihmës juridike ndërkombëtare për të gjitha rastet që përfshijnë pasurinë e sekuestruar dhe konfiskuar, duke administruar pasurinë e sekuestruar apo konfiskuar në bazë të kërkesës së bërë nga një shtet tjetër.
- Mundëson shitjen e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar, sipas vendimit të gjykatës kompetente.
- Administron të dhënat lidhur me pasurinë e sekuestruar dhe të konfiskuar në një sistem të centralizuar kompjuterik.
- Ofron këshilla për Prokurorinë, Gjykatën dhe institucionet tjera mbi natyrën specifike të procesit të administrimit të pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar, me qëllim të ofrimit të ndihmës për planifikimin sekuestrimeve, apo konfiskimeve të mundshme.
- Lidhë Memorandume të Bashkëpunimit me organet partnere dhe institucionet relevante për

t'u dakorduar për marrëdhëniet dhe përgjegjësitë, si dhe për të rritur performancën , në përputhje me dispozitat e këtij Ligji.

- Agjencia është e përkushtuar në zbatimin e objektivave dhe veprimeve që dalin nga Ligji" (*MD.RKS-GOV,2016*).

2.2.10 Shembuj të Pastrimit të Parave nga vendet e huaja

- SH.B.A arreston ekspertin e pastrimit të parave për pastrim parash

“Për dekada të tëra, Bruce Bagley është vlerësuar si një ekspert kryesor për krimin e organizuar në Amerikën Latine, veçanërisht për pastrimin e parave. Pastaj po ky i njejt profesori i Universitetit të Miami pati telashe për mënyrën se si ai e zbatoj atë njohuri. Bagley u arrestua me akuzën e pastrimit të 3 milion dollarëve në emër të shtetasve të huaj të korruptuar që grumbulluan fondet e paligjshme përmes ryshfeteve dhe duke përvetësuar nga një projekt i punëve publike në Venezuelë. Prokurorët federalë në Manhattan akuzuan gjithashtu Bagley për përfitim te rreth 10% të parave - rreth 300,000 dollarë - të fituara mbi 14 transaksione midis nëntorit 2017 dhe prillit 2019.

73-vjeçari ishte një profesor i marrëdhënieve ndërkombëtare për një kohë të gjatë në universitet, duke shkruar dhe redaktuar disa libra për, kartelet e drogës dhe korrupsionin, përfshirë trafikimin e drogës, krimin e organizuar dhe dhunën në Amerikën e sotme. Por profesori pastaj u akuzua për dy vepra: pastrim parash dhe një akuzë komploti. Sipas aktakuzës në gjykatën federale të Manhattan, Bagley filloi të merrte depozita mujore prej qindra mijëra dollarësh nga llogaritë bankare në Zvicër dhe Emiratet e Bashkuara Arabe, të cilat të dyja kanë qenë të lidhura me një kombëtar kolumbian pa emer. Pas marrjes, ai do të tërhiqte rreth 90% të fondeve në formën e një arkëtari dhe do t'ia dorëzonte një shtetasi të dytë kolonian pa emer, pastaj Bagley do të dërgonte fondet e mbetura në llogarinë e tij personale. Dokumentet e gjykatës gjithashtu pretendojnë se Bagley u përpoq të mbulonte gjurmët e tij duke krijuar kontrata të rrejshme për të pastruar qindra mijëra dollarë që ai ishte duke bërë nga kjo skeme” (*NPR.ORG,2019*).

"Rreth mësimin të vetëm që duhet të mësohet nga Profesori Bagley sot është se përfshirja e

vetvetes në skemat e korrupsionit, ryshfetit dhe përvetësimit do të çojë në një aktakuzë," (William F. Sweeney Jr.), kreu i FBI-së në New York Field Office.

- Eksperti i mashtrimit të hipotekave me pronat e vjetra

“Një ekspert i mashtrimit të hipotekave kishte bërë një komplot për vlerësimin e pasurive të patundshme, duke bërë pastrimin e parave përmes blerjes së pronave banesore të vjetra dhe të lira, dhe duke i'u vendosur atyre vlera të larta mashtruese. Strategjia e tij ishte t'i bindte bankat ti huazojnë më shumë para sesa që shtëpitë kishin vlerë, dhe të ardhurat e tepërta të huasë ti përvetësonte. Pastaj huamarrësit në këtë plan i paracaktonin hipotekat, duke i lënë huadhënësit kolateral praktikisht të pavlefshëm.” (*Ims-ExpertServices*).

3. DEKLARIMI I PROBLEMIT

Ashtu siç shihet nga statistikat e dhëna më lartë Kosova gjatë viteve 2015,2016 dhe 2017 nuk ka rezultuar me sukses të mjaftueshëm, duke filluar nga hetimet e deri tek zgjidhja e lëndëve të cilat janë paraqitur në Institucionet Gjyqësore, të cilat kanë pasur shtrirje mjaftë të madhe duke qenë më të përhapura, e tek këto institucione vërejmë një heshje ose mosefikasitet. Veprime të tilla shkaktojnë probleme në tërë shtetin apo shoqërinë e vendit duke sjellë një mori pasojash.

Shteti i Kosovës duhet të luftojë për ta rritur potencialin në lidhje me luftimin e këtyre fenomeneve, e kjo gjë duhet të vlejë edhe për institucionet prej atyre financiare, institucionet e drejtësisë e deri tek qeveria. Sepse përhapja edhe më e madhe në mosluftimin e këtyre veprave mund të vijë në rritje cdo herë e më shumë, si rezultat i mungesës së ndjekjes në mënyrë efektive. Shteti i Kosovës ka treguar për punën që bënë, përvojat dhe sfidat më të cilat përballet dhe shpesh duke kërkuar ndihmën nga organizatat ndërkombëtare për ndjekjen më efikase, për të shënuar progres sa i përket shkëmbimit të informacioneve dhe ngritjen e nivelit të bashkëpunimit ndërkombëtar. Antarësimi në organizatat e huaja ndërkombëtare për luftimin e fenomeneve të dëmshme të cilat qojnë vendin në humbje, e sidomos vendet me stabilitet të dobët dhe ekonomi jo stabile, është shumë i rëndësishëm sepse kontribon fuqishëm dhe kjo gjë është shumë e rëndësishme për shtetin e Kosovës. Me antarësimin në organizata apo institucione të tilla bëhet edhe ngritja e kapaciteteve profesionale për institucionet tona dhe ofrimi i informatave për institucionet e zbatimit të ligjit në Republikën e Kosovës.

Duke qenë se Kosova është ende një shtet i ri e në formim e sipër, probleme të shumta janë të trashëguara në njëfarë forme qysh nga periudha Jugosllave, që kanë lënë ndikim të madh edhe sot në ekonomi, sepse Kosova ka ende vështirësi në përballje me standardet e ekonomisë e pastaj tek politika në vend. Kështu institucionet e vendit shpesh janë të detyruara ti përdorin kapacitetet aq sa është e mundur, për atë arsye janë të interesuar për bashkëpunim dhe se kanë nevojë për mbështetje.

Një arsye tjetër që shfaqet si problem mjaftë i madh e kemi cekur edhe më lartë, është edhe ndërhyrja nga njerëz me ndikim, duke ndikuar kështu në mos zbardhjen apo mosndjekjen e shumë rasteve të cilat dihen qartë por krijohet një heshtje e cila vjen si rezultat i ndikimit të këtyre personave. Andaj me gjithë këto probleme, personat me ndikim nuk duhet të bëhen

pengesë dhe problem më i madh duke qar vendin poshtë, por duhet të punohet me përpikmëri dhe të bëhet një hetim dhe analizë e vecantë edhe për këtë fenomen që në njëfarë mënyre nuk e lë vendin apo institucionet e vendit të zhvillohen dhe të shenojnë progres për nga zbardhja e rasteve. Për veprat penale të kriminalitetit ekonomik dhe pastrimi i parave duket marrë masa adekuate, preventive duke studiuar paraprakisht dimensionet, vëllimin, paraqitja e tyre dhe rrethanat që i shkaktojnë ato, pra vlenë të theksohet prapë se mos zbulimi dhe mos ndëshkimi i këtyre krimeve sjellë pasoja në mospengimin e shfaqjes së tyre.

4. METODOLOGJIA

Metodologjia e përdorur për realizimin e këtij hulumtimi është e bazuar në qasjen hulumtuese, kryesisht në modelin kuantitativ dhe teorik deri tek modeli përshkrues, që përfshinë mbledhjen e të dhënave relevante, modelimin dhe analizimin e të dhënave, si dhe në fund vlerësimin e rezultateve. Ky lloj studimi është përdorur me qëllim që të zbuloj arsyet themelore që ndikojnë në këtë hulumtim, strategjinë e vlerësimit të të dhënave të nxjerrura nga hulumtimi, ku në fund të gjitha të dhënat do të mblidhen, të përpunohen dhe të analizohen. Poashtu duke përdorur analizën statistikore të të dhënave në lidhje me veprat penale të Kriminalitetit Ekonomik dhe Pastrimit të Parave. Pra, ky punim është bazuar mbi të dhënat e marra nga KGJK, në formë të statistikave të cilat janë raportuar vetëm mbrenda afatit 3 vjeçar, të cilat janë mbledhur gjatë atyre viteve nga hetimet që janë bërë, dhe tani po analizohen dhe shfaqen statistikisht për qëllim të studimit të tyre, duke u paraqitur në bazë të tabelave. Bazuar në kërkesat për të përmbushur qëllimin e këtij punimi, janë marrë të dhëna të qëndrueshme dhe më të përgjithshme, të dhëna të mbledhura nga shqyrtimi i literaturës, hulumtime, analizimin e të dhënave, burime konkrete, të cilat kanë ndimuar në arritjen e konkluzioneve.

Për realizimin e metodologjisë janë përdorur:

- Hulumtimet në lidhje me Kriminalitetin Ekonomik dhe Pastrimit të Parave si terme ndërkombëtare.
- Hulumtimet në lidhje me Kriminalitetin Ekonomik dhe Pastrimit të Parave si koncept në literaturën vendore, me qëllim të informimit për menyrat e përhapjes së tyre, ndikim e tyre, format, efektet, vecoritë etj .
- Informata lidhur me kornizën ligjore, strategjitë kombëtare, institucionet përgjegjëse në Republikën e Kosovës dhe faktorët për përmirësimin dhe ndjekjen sa më efektive për parandalimin e këtyre fenomeneve.
- Informata të marra nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në lidhje me raportimin e rasteve të veprave penale të Kriminalitetit Ekonomik dhe veprës së Pastrimit të Parave në vecanti.

5. PREZANTIMI DHE ANALIZA E REZULTATEVE

Në këtë punim një vëmendje e posaçme i është kushtuar Kriminalitet Ekonomik dhe Pastrimit të Parave, fenomene me të cilat ballafaqohet shteti i Kosovës. Një mori pyetjesh janë të lidhura me çështjen e pengesave të këtyre veprimeve në qëllimin e ndjekjes penale apo luftimin e tyre. Në përgjithësi, pengesat janë ndarë në dy lloje të veçanta, në ato të shkaktuara nga faktorët e jashtëm si dhe pengesat specifike për vetë shtetin e Kosovës dhe institucionet e tij. Pengesat e brendshme janë të lidhura me strukturën organizative apo me aftësitë e kufizuara menaxhuese të këtyre situatave. Në të kundërtën, pengesat e jashtme burojnë nga rrethina jo-stabile makroekonomike si dhe institucionet dhe politikat e qeverisë.

Disa nga pengesat më të përhapura të cilat mund ti përmendim janë:

- Mungesa e mbështetjes ndërkombëtare,
- Heshtja e shoqërisë për këto krime,
- Mosefikasiteti i ndjekjeve penale në këto krime,
- Mungesa e kapaciteteve në institucionet e zbatimit të ligjit,
- Ndikimi nga personat e ndryshëm me ndikim në vend,
- Mungesa e informacioneve,
- Mungesa e trajnimeve,
- Gjetja e partnerëve të jashtëm për procedurat e kryerjes së këtyre veprimeve,
- Gjetja e partnerëve të brendshëm për procedurat e kryerjes së këtyre veprimeve,
- Moszbatimi i ligjit,
- Politika e dobët,
- Ekonomia jostabile,
- Faktorët e ndryshëm shoqërorë etj.

Kosova si qëllim primarë në vitet në vazhdim është që të arrije rritje të madhe dhe të shpejtë ekonomike por gjithashtu edhe ti luftojë krimet në përgjithësi në mënyrë të fuqishme, pasi që janë dy pika kryesore apo me rëndësi shumë të madhe për tu arritur, derisa të vijmë në fuqizimin dhe krijimin e një shteti më stabil dhe më të qëndrueshëm.

Suksesi i luftimit të krimeve në fjalë nuk mund të ndiqet në mënyrë efektive nëse nuk ndodhë

secilen herë e më fuqishëm një ri-organizim i duhur i shoqërisë, i strukturës ekonomike, i politikës, i institucioneve të drëjtësisë dhe atyre ligjvënese.

Që të arrihet një rezultat në këtë aspekt në Republika e Kosovës duhet ti kushtojë vëmendje të duhur dhe të mbështetet në:

- Korniza Ligjore,
- Strategjitë Kombëtare,
- Raportet Strategjike dhe Planet e Veprimit,
- Konventat Ndërkombëtare,
- Aktet e tjera nën-ligjore.

Politikat për përmirësimin dhe ballafaqimin e duhur në lidhje me këto krime duke mos anashkalluar krimet në pergjithësi, përfshijnë:

- Përmirësimin e kushteve në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare,
- Përmirësimin në bashkëpunimin më të ngushtë me të gjitha institucionet e zbatimit të ligjit si Prokurorinë, Gjykatat, Doganën e Kosovës, Policinë, Njësinë e Inteligjencës Financiare, Administratën Tatimore të Kosovës, Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar, si dhe Agjensionet tjera relevante.
- Krijimin të një sistemi informativ më efikas,
- Zhvillimin e programeve trajnuese të vazhdueshme,
- Përmirësimin e kapaciteteve në të gjitha institucionet e zbatimit të ligjit,
- Realizimin e takimeve me bashkëpunorë të huaj. Pra, gjetjen e partnerëve etj.

6. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Krimet Ekonomike dhe Krimi i Pastrimit të Parave në shoqërinë tonë kanë qenë gjithmonë prezente sikur në të gjitha vendet e botës, sepse tashmë këto janë fenomene që kanë përfshirë tërë botën. Prezenca e tyre është shumë e vështirë që të zhduket në mënyrë të tërësishme, sepse këto krime gjithmonë do të egzistojnë. Me rëndësi është që të luftohet pranija e tyre në masë sa më të madhe që të jetë e mundur, sepse kjo gjë sjellë përfitime pozitive në krijimin më efektiv të shtetit. Për parandalimin e këtyre krimeve dhe luftimin e tyre duhet të fillohet nga shoqëria, të cilët duhet të kuptojnë ndikimin e këtyre krimeve dhe efektet që i shkaktojnë ato, kështu të jenë të gatshëm që ta japin ndihmën e tyre duke mos u kyqur në aktivitete të tilla kriminale.

Në kuadrin e politikës së Kosovës, zhvillimi i bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare konsiderohet të jetë një faktor kyç për përmirësimin dhe arriten e luftimit të krimit në përgjithësi, sepse marrëdhëniet e dobëta në mes të ndërkombëtareve kanë pasojë serioze. Rritja e kapaciteteve në tërësi është mundësi reale dhe një hap me rëndësi për krijimin e mekanizmave më të fuqishëm shtetërorë dhe institucional.

Zvogëlimi i veprimtarive kriminale për të cilat po flasim është një proces mjaftë i vështirë për tu ndjekur dhe do kohën e vet, kjo gjë mund të arrihet sepse egzistojnë raporte strategjike, institucione të zbatimit të ligjit, njësi, agjencione, institucione ndërkombëtare në bashkëpunim me ato të vendit poashtu korniza ligjor. Për të rezultuar me sukses në misionin e tyre ato duhet ta ushtrojnë punën e tyre në mënyrë të pavarur dhe gjithmonë të jenë të hapura për bashkëpunim sa më të mirë dhe efikas, qoftë me ndërkombetarët ashtu edhe nëpërmjet tyre. Kështu dita ditës mund të arrijnë punën e tyre në luftimin e këtyre veprimeve, por gjithmonë duke mos i eliminuar në tërësi. Kjo është sfida kryesore e tyre në punën dhe efikasitetin e duhur për parandalimin, hetimin, gjykimin dhe luftimin e tyre.

Duke i pasur parasyshë efektet edhe pasojat e shumta që shkaktohen nga këto lloj veprimtarive të kundërligjshme dhe për të ardhur tek një përfundim të cilin e dëshirojmë për vendin tonë kërkohen veprime konkrete të tilla si:

- Antarësimin në grupin e shteteve kundër këtyre krimeve,
- Harmonizimin e legjislacionit vendorë me atë ndërkombëtar,
- Përmirësimin e bashkëpunimit gjyqësor me vendet e tjera, me anë të marrëveshjeve,
- Bashkëpunimin ndërkombëtar në hetimet e krimit të pastrimit të parave,
- Bashkëpunimin ndërkombëtar në hetimet e krimeve ekonomike,
- Përmirësimin e kushteve në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare,
- Përmirësimin në bashkëpunimin më të ngushtë me institucionet e zbatimit të ligjit dhe të partnerëve ndërkombëtarë,
- Krijimin të një sistemi informativ më efikas,
- Zhvillimin e programeve trajnuese të vazhdueshme,
- Realizimin e takimeve me bashkëpunorë të huaj. Pra, gjetjen e partnerëve dhe arritjen e marrëveshjeve etj.

Republika e Kosovës duhet ta ndjekë me përpikmëri Kornizën Ligjore dhe në rast nevoje për situatat problematike duhet të jetë e gatshme për fuqizimin e ligjit dhe nxjerrjen e ligjeve të reja, me qëllim të ndikimit të këtyre ligjeve në përhapjen në masë sa më të vogël të krimeve kështu kontrolli mbi këto krime të jetë më i madh.

7.REFERENCAT

INTERPOL. (2019) *Finançal Crime*. [Online] Qasshëm nga:
<https://www.interpol.int/en/Crimes/Financial-crime>

A.KRASNIQI. (nr.4/2003) *E drejta-Law*. [Online] *Ekonomia dhe Kriminaliteti Ekonomik*.
Qasshëm nga:
https://www.researchgate.net/publication/289768105_Ekonomia_dhe_kriminaliteti_ekonomik

EKONOMIA-KS. (2019) *Ligji Anti-Mafia rrit efikasitetin në konfiskimin e pasurisë në Kosovë*. [Online] Qasshëm nga: <http://www.ekonomia-ks.com/sq/ekonomi/ligji-anti-mafia-rrit-efikasitetin-ne-konfiskimin-e-pasurise-ne-kosove>

I.SALIHU. (2016) *Kodi Penal i Republikës së Kosovës*. Teksti integral-parathënie dhe shpjegime të shkurtëra. Prishtinë.

A.KRASNIQI. (nr.4/2003) *E drejta-Law*. [Online] *Kuptimi i Kriminalitetit Ekonomik*.
Qasshëm nga:
https://www.researchgate.net/publication/289768105_Ekonomia_dhe_kriminaliteti_ekonomik

M.SUCESKA. (2006) *Bazat e Kriminaliteti Ekonomik*. [Online] Qasshëm nga:
<https://www.slideshare.net/NasufGrmizaj/bazat-e-kriminalitetit-ekonomik>

R.HALILI. (2011) *Kriminologjia*. Kriminaliteti Ekonomik. Botimi i shtatë – Prishtinë.

GZK.RKS-GOV. (2019) *KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS*. [Online] *KAPITULLI XXV-VEPRAT PENALE KUNDËR EKONOMISË*. [Online] Qasshëm nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2834>

R.HALILI. (2011) *Kriminologjia*. Format dhe vecoritë e kriminalitetit ekonomik dhe të kryesve të kriminalitetit ekonomik. Botimi i shtatë – Prishtinë.

W.TUPMAN (2015). *The characteristics of economic crime and criminals*. [Online] Qasshëm nga: <https://www.elgaronline.com/view/edcoll/9781783475780/9781783475780.00009.xml>

A.KRASNIQI (2003). *Ekonomia Dhe Kriminaliteti Ekonomik*. [Online] Qasshëm nga: https://www.researchgate.net/publication/288993877_EKONOMIA_DHE_KRIMINALITETI_EKONOMIK

SLIDESHARE, A.Shabani & M.Budimliq (2011). *KRIMINOLOGJIA*, [Online] Qasshëm nga: <https://www.slideshare.net/NasufGrmizaj/kriminologjia>

UNITED NATIONS. (2005) *Consequences of Economic Crimes affect people's sense of society's fairness, crime congress' committee 1 told*. [Online] Qasshëm nga: <https://www.un.org/press/en/2005/soccp324.doc.htm>

ASSETS PUBLISHING SERVICE.GOV. (2018) M.Heeks, S.Reed, M.Tafsiri and S.Prince. *The economic and social costs of crime*. [Online] Qasshëm nga: https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/732110/the-economic-and-social-costs-of-crime-horr99.pdf

EUROPOL EUROPA. *Economic Crime*. [Online] Qasshëm nga: <https://www.europol.europa.eu/crime-areas-and-trends/crime-areas/economic-crime>

CIPCE – (Eng.Center for Research and Prevention of Economic Crime). *What is economic crime*. [Online] Qasshëm nga: <http://www.cipce.org.ar/en/what-is-economic-crime>

KOSOVO POLICE. R.Shillova. Departamenti i hetimeve. *Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit*. [Online] Qasshëm nga: <https://www.kosovopolice.com/departamentet/departamenti-i-hetimeve/>

KLI-KS.ORG. (2011) INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI. *Policia e Kosovës: Luftimi i krimeve ekonomike dhe korrupsionit*. [Online] Qasshëm nga: <https://kli-ks.org/policia-e-kosoves-luftimi-i-krimeve-ekonomike-dhe-korrupsionit/>

FATF-GAFI.ORG. (2019) THE FINANCIAL ACTION TASK FORCE (FATF), *Money Laundering*. [Online] Qasshëm nga: <https://www.fatf-gafi.org/faq/moneylaundering/>

R.HALILI. (2011) *Kriminologjia*. “Larja” e Parave. Botimi i shtatë – Prishtinë.

CRIMINAL FINDLAW. Last updated February 06, 2019. Created by FindLaw's team of legal writers and editors. *Money Laundering*. [Online] Qasshëm nga: <https://criminal.findlaw.com/criminal-charges/money-laundering.html>

INTERPOL. (2020) *Money Laundering. Fighting money laundering goes hand in hand with investigating the crimes it is linked to*. [Online] Qasshëm nga: <https://www.interpol.int/en/Crimes/Financial-crime/Money-laundering>

JURIDIKSI E-MONISTE. L.Gjonca. *Pastrimi i produkteve të veprës penale dhe krimi i organizuar*. [Online] Qasshëm nga: <http://juridiksi.e-monsite.com/faqe/e-drejta-penale/pastrimi-i-parava-te-pista.html>

MF.RKS.GOV. (2019) *Ministria e Financave*. [Online] Qasshëm nga: <https://mf.rks.gov.net/desk/inc/media/DBA6BCC4-B875-4A30-9FDB-C144736597B2.pdf>

NPR.ORG. (2019) *U.S. Arrests Money-Laundering Expert For Laundering Money*. [Online] Qasshëm nga: https://www.npr.org/2019/11/19/780877837/u-s-arrests-money-laundering-expert-for-laundering-money?fbclid=IwAR19gIAfqjr8LZCE_LuPub_FrjtWvQXQnctlbRkMI-M03loGyRgFCivFnz4

IMS-EXPERTSERVICES. *Mortgage Fraud Expert in Distressed Property*. [Online] Qasshëm nga: https://www.ims-expertservices.com/case_studies/mortgage-fraud-expert-in-distressed-property/?fbclid=IwAR1F6vKcxcUVMEzcJPJPvOUYDwV_9slGE8sounY4SqZr5U2z-ju4m9U-rHo

MONEY LAUNDERING. (2017) *Money Laundering: a three-stage process*. [Online] Qasshëm nga: https://www.moneylaundering.ca/public/law/3_stages_ML.php

HG.ORG. *Stages of Money Laundering*. [Online] Qasshëm nga: <https://www.hg.org/legal-articles/stages-of-money-laundering-40408>

TNI.ORG. M.Levi & P.Reuter. *Money Laundering*. [Online] Qasshëm nga: https://www.tni.org/files/publication-downloads/money_laundering_levi_and_reuter.pdf

RESEARCHGATE. (2018) V.Beqiri & N.Beqiri. *Negative Effects On The Domestic Economy Caused By Money Laundering*. [Online] Qasshëm nga: https://www.researchgate.net/publication/330971707_NEGATIVE_EFFECTS_ON_THE_DOMESTIC_ECONOMY_CAUSED_BY_MONEY_LAUNDERING

FIUMAUROITIUS.ORG - Financial Intelligence Unit (FIU). *Consequences of Money Laundering*. [Online] Qasshëm nga: <http://www.fiumauritius.org/English/Pages/Definition-of-Money-Laundering.aspx>

WALEOLUSI FILES WORDPRESS. (2002) *The negative effects of Money Laundering on Economic Development*. [Online] Qasshëm nga: <https://waleolusi.files.wordpress.com/2013/05/the-negative-effects-of-money-laundering-on-econom.pdf>

GZK.RKS-GOV. (2016) Kuvendi i Republikës së Kosovës. *LIGJI Nr. 05/L -096 - PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE LUFTIMIN E FINANCIMIT TË TERRORIZMIT, KAPITULLI I - DISPOZITAT E PËRGJITHSHME*. [Online] Qasshëm nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12540>

GZK.RKS.GOV. (2019) Kuvendi i Republikës së Kosovës. *KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS*. [Online] Qasshëm nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2834>

KRYEMINISTRI-KS. (2014) Republika e Kosovës. *Strategjia Kombëtare E Republikës Së Kosovës Për Parandalimin Dhe Luftimin E Ekonomisë Joformale, Pastrimin E Parave, Financimin E Terrorizmit Dhe Krimeve Financiare 2014-2018*. [Online] Qasshëm nga: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_Kombetare_e_Republikes_se_Kosoves_per_Parandalimin_dhe_Luftimin_e_Ekonomise_Joformale,_Pastrimin_e_Parave,_Financimin_e_Terrorizmit_dhe_Krimeve_Financiare_2014-2018.pdf

MF-RKS.GOV. (2019) Republika e Kosovës, Ministria e Financave. *Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023*. [Online] Qasshëm nga: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/DBA6BCC4-B875-4A30-9FDB-C144736597B2.pdf>

KUVENDI5.VOTAIME. (2016) Ligji Për Parandalimin E Pastrimit Të Parave Dhe Luftimin E Financimit Të Terrorizmit, *Bashkëpunimi Ndërkombëtar*. [Online] Qasshëm nga [http://kuvendi5.votaime.org/Uploads/Data/Documents/LIGJI NR. 05 L-096 LIGJ PER PARANDALIMIN E PASTRIMIT TE PARAVE DHE LUFTIMIN E FINANCIMIT TE TERRORIZMITLIGJI NR. 05 L -096 LIGJ PER PARANDALIMIN E P_xGEXFHgfc8.pdf](http://kuvendi5.votaime.org/Uploads/Data/Documents/LIGJI_NR.05_L-096_LIGJ_PER_PARANDALIMIN_E_PASTRIMIT_TE_PARAVE_DHE_LUFTIMIN_E_FINANCIMIT_TE_TERRORIZMITLIGJI_NR.05_L-096_LIGJ_PER_PARANDALIMIN_E_P_xGEXFHgfc8.pdf)

KIPRED. (2016) - Instituti Kosovar për kërkime dhe zhvillime të politikave. *REAGIMI NDAJ PASTRIMIT TË PARAVE NË KOSOVË: NË MES TË POLITIKAVE DHE PRAKTIKËS*. [Online] Qasshëm nga: [http://www.kipred.org/repository/docs/5th Brief Money Laundering Albanian FINAL 810236.pdf](http://www.kipred.org/repository/docs/5th_Brief_Money_Laundering_Albanian_FINAL_810236.pdf)

GZK.RKS-GOV. (2016) *Neni 3. Kompetenca e Prokurorisë*. [Online] Qasshëm nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12540>

GZK.RKS-GOV. (2016) Kuvendi i Republikës së Kosovës, *KAPITULLI II- NJËSIA PËR INTELIGJENCË FINANCIARE*. [Online] Qasshëm nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12540>

MF.RKS-GOV. (2017) *Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës bëhet anëtare e EGMONT GROUP*. [Online] Qasshëm nga: <https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,2,441>

COHU.ORG. (2016) *Konfiskimi i Pasurisë në Kosovë*. [Online] Qasshëm nga: [http://www.cohu.org/repository/docs/Konfiskimi i Pasuris%C3%AB_n%C3%AB_Kosov%C3%AB_ALB_Final_v2_899978.pdf](http://www.cohu.org/repository/docs/Konfiskimi_i_Pasuris%C3%AB_n%C3%AB_Kosov%C3%AB_ALB_Final_v2_899978.pdf)

MD.RKS-GOV. (2016) Kuvendi i Republikës së Kosovës, *LIGJ PËR ADMINISTRIMIN E PASURISË SË SEKUESTRUAR DHE TË KONFISKUAR*. [Online] Qasshëm nga: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/A32E5D12-61C3-4210-8C69-44BDD1821B31.pdf>

MD.RKS-GOV. (2018) Kuvendi i Republikës së Kosovës, *LIGJ PËR KOMPETENCAT E ZGJERUARA PËR KONFISKIMIN E PASURISË*. [Online] Qasshëm nga: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/30F82D3E-3312-4AC5-A25F-366E98B963B4.pdf>

MD.RKS-GOV. (2019) Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Kapitulli VII-Konfiskimi i Instrumentalitetit dhe Dobisë Pasurore të Veprave Penale*. [Online] Qasshëm nga: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/6A2D4377-6AE1-4530-909F-3FB2680CD1EC.pdf>

MD.RKS-GOV. Republika e Kosovës - Ministria e Drejtësisë. *Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar*. [Online] Qasshëm nga: <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,17>

MD.RKS-GOV. (2016) Kuvendi i Republikës së Kosovës, *LIGJ PËR ADMINISTRIMIN E PASURISË SË SEKUESTRUAR DHE TË KONFISKUAR*. [Online] Qasshëm nga: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/A32E5D12-61C3-4210-8C69-44BDD1821B31.pdf>

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), *Statistikat e Veprave Penale kundër Ekonomisë*. (Tabela 1 dhe 2), Qasshëm nga: kgjk@rks-gov.net

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), *Statistikat e Vepres Penale të Pastrimit të Parasë*. (Tabela 3 dhe 4), Qasshëm nga: kgjk@rks-gov.net

